

# Raport mbi analizën e gjendjes së reformave në sektorin e sigurisë në Maqedoni (viti 1991–2008)



*"Ndërtimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për hartim dhe monitorim  
të reformave të sigurisë në Ballkanin perëndimor, 2009-2011"*

# **Raport mbi analizën e gjendjes së reformave në sektorin e sigurisë në Maqedoni (viti 1991–2008)**

## **Përbajtja:**

<b>Lista e shkurtesave.....</b>	<b>4</b>
<b>Hyrje.....</b>	<b>5</b>
<b>Periudha 1: Nga pavarësia e deri te konflikti (v.1991–2001) .....</b>	<b>7</b>
<b>Periudha 2: Nga Ohri e deri në Bukuresht (v. 2001–2008) .....</b>	<b>18</b>
<b>Periudha 3: Nacionalizmi pas vetos (v. 2008) .....</b>	<b>30</b>
<b>Përfundime .....</b>	<b>34</b>
<b>Anekse</b>	
<b>Anekse 1: Analiza e aktorëve kyç politik .....</b>	<b>36</b>
<b>Anekse 2: Kronologjia së reformave në sektorin e sigurisë 1991 – 2009.....</b>	<b>43</b>
<b>Bibliografi .....</b>	<b>61</b>

Ky publikim është produkt i projektit "Ndërtimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për hartim dhe monitorim të reformave të sigurisë në Ballkanin perëndimor", i finansuar nga Ministria e punëve të jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë. Projekti në fjalë është projekt rajonal, ku përfshihen 7 organizata think-tank nga vendet si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, dhe Serbia, dhe implementohet në koordinim me DCAF ([www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch)). Ky hulumtim është zhvilluar në bazë të metodologjisë origjinale të krijuar nga Qendra e Beogradit për politikë të sigurisë - BCSP ([www.ccmr-bg.org](http://www.ccmr-bg.org)).

Verzioне të ndryshme të këtij hulumtimi janë rishikuar dhe korrigjuar nga BCSP (Miroslav Haxhić and Sonja Stojanović) dhe DCAF (David Law dhe Suzana Anghel). Autorët i janë mirënjojohës Ruchir Sharma (DCAF) për leximin dhe korrigimin e këtij hulumtimi.

## Hyrje

### Listë e shkurtesave:

ARM – Armata e Republikës së Maqedonisë

PDSH – Partia Demokratike Shqiptare

BDI – Bashkimi Demokratik për Integrin

KE – Komisioni evropian

UE – Unioni evropian

EUPOL – Policia evropiane

IRJM – Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

AK – Agjencioni për kundërzbullim

ICITAP – Programa ndërkombëtare për ndihmë dhe trajnim gjatë hetimeve krimanilistike

APJ – Armata Popullore e Jugosllavisë

NATO – Aleanca verioatlantike

PDP – Partia Demokratike Popullore

UÇK - Ushtria Çlirimtare Kombëtare

MKO – Marrëveshja Kornizë e Ohrit

OSCE – Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

PPD-PDP – Partija për Prosperitet Demokratik

PPP – Partneriteti për paqë

MSA – Marrëveshja për stabilizim dhe asocim

LSDM – Lidhja Socijaldemokrate e Maqedonisë

RSFJ – Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

DSK – Drejtoria për siguri dhe kundërzbullim

KB – Kombet e Bashkuara

UNPREDEP – Forcat e vendosura preventive të Kombeve të Bashkuara

OBRM-PDUKM (VMRO-DPMNE) – Organizata e Brendshme Revolucionare


Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas

### Gjendja e gjërë socio-politike

**Periodizimi:** Periudha 1: Prej vitit 1991 e deri në vitin 2001, nga shpallja e pavarësisë e deri te konflikti etnik në vitin 2001. **Periudha 2:** Prej vitit 2001 e deri në vitin 2008, pas konfliktit, para NATO-s; **Periudha 3:** Prej vitit 2003 e deri më sot, nacionilizmi pas vetos.

Ky rapport e përfshinë gjendjen në sektorin e përgjithshëm politik dhe të sigurisë në dy deceniet e kaluara, pas shpalljes së pavarësisë së Maqedonisë, i cili i kyç rrjedhat dhe situatat më kryesore të cilat e anashkalojnë zhvillimin politik dhe përparimin e reformave në sektorin e sigurisë në Maqedoninë paskomuniste. Për nevojat e këtij rapporti, analiza e periudhës paskomuniste është ndarë në tri pjesë, të cilat i përgjigjen tri periudhave, në të cilat është ndarë ngjarja prej vitit 1991 e këndej, me qëllim që të arrihet qartshmëri dhe koherencë analitike. Për çdo nga këto tri periudha, realizuan analizë të zhvillimeve më kryesore politike, si dhe të ndryshimeve institucionale. Në bazë të kësaj analize, çdo periudhe u janë ndarë karakteristikat e veçanta - pasautoritative, e konfliktit, paskonfliktit ose integrative. Në Aneksin e bashkangjitur vijon pasqyra e shkurtër e aktorëve kryesorë politik dhe roli i tyre në reformat në sektorin e sigurisë, si dhe tranzicioni politik në Maqedoni.

Në periudhën e parë analizohet periudha prej shpalljes së pavarësisë nga Jugosllavia, në vitin 1991, e deri te konflikti etnik në vitin 2001. Këto vite shënonin një decenien e parë të pavarësisë dhe politikat demokratike në Republikën e Maqedonisë. Kjo periudhë është me rëndësi të veçantë sepse shënon themelimin e shtetit maqedonas, Armatës, institucioneve demokratike dhe ligjdhënëse, të cilat e formojnë zhvillimin e mëvonshëm dhe rrugën qe Maqedonia do ta njdek në vitet që do të pasojnë. Gjendja gjatë kësaj periudhe është kryesisht **pasautoritative**, si rezultat i tranzicionit, nga regjimi komunist në ate demokratiko-politik, si dhe mbizotërimi i pyetjeve tradicionale të agjendës politike. Disa elemente parae konfliktit paraqiten gjatë kohës së viteve të vonshme të nëntëdhjeta, si rezultat i keqësimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe incidenteve të shpeshtuara etnike. Sido që të jetë, problemet etnike nuk do të ngriten në agjendën politike deri më vitin 2001.



Periudha e dytë e përfshin konfliktin etnik në vitin 2001 dhe zgjatet deri në Samitin e Bukureshtit të NATO-s, në fillim të vitit 2008. Konflikti në vitin 2001 fuqishëm ndikoi në gjendjen politike dhe të sigurisë në Maqedoni.

Ai krijoi dhunë ndërretnike dhe kulminoi me reforma të thella të rregullimit kushtetues dhe institucional në demokracinë maqedonase. Nga atje nis fillimi i një periudhe të re për politikën maqedonase, periudhë ku probleme dominante janë ato të pas konfliktit për rekonstruimin, çarmatimin dhe demobilizimin e grupeve të armatosura, krimet e luftës dhe problemet etnike në raport me ndryshimet kushtetuese, juridike dhe të reformave në administratën publike. Gjendja politike në këtë periudhë është kryesisht **e paskonfliktit**. Kjo dëshmon përpjekjet intenzive për kyçje në UE dhe NATO, si dhe përpjekjet për plotësimin e kërkesave të domosdoshme të vendosura për kyçje në këto organizata. Nga atje, konsiderohet si adekuate theksimi i natyrës **integrative** i gjendjes politike gjatë kohës së kësaj periudhe.


Periudha e fundit, pra, fillon menjëherë pas Samitit të Bukureshtit të NATO-s, në vitin 2008. Gjatë të njejtë vit, Maqedonia i plotësoi të gjitha kërkesat e domosdoshme për bashkangjitje në Aleançë, por nuk mori ftesë për anëtarësim në NATO, për shkak të vetos që vendosi Greqia, e nxitur nga pyetja për emrin. Samiti i Bukureshtit është ngjarje me rëndësi për Maqedoninë për dy arsy. E para është ajo që ai i pranon përpjekjet e suksesshme për reformimin e sektorit të sigurisë pas konfliktit të vitit 2001, deri në shkallën e ofrimit të ftesës për anëtarësim në NATO. Kjo paraqet tregues të qartë për ballafaqimin me sukses me sfidat e paskonfliktit dhe shënon fundin e periudhës paraprake të analizuar. Arsyja e dytë është ajo që Samiti i Bukureshtit nuk rezultoi me anëtarësim të Maqedonisë në NATO, si shtetet e tjera paskomuniste. Kjo ngjarje do të shënojë rrugë tjetërfari për Maqedoninë, e cila dy vite pas Samitit të Bukureshtit nuk do t'i ketë të zhgjidhura problemet me Greqinë, rrugë tjetërfari nga rrugët e shteteve të tjera në regjion. Edhe pse i shkurtër, kjo periudhë është e ndryshme nga dy të tjerat, dhe nga analiza e zhvillimit të ri mund të përfundohet se ajo karakterizohet me **nacionalizëm pas vetos**, term me të cilin do të shërbehem i përgjatë kohës së gjendjes dominante politike nga kjo periudhë.

## PERIUDHA 1: PREJ PAVARËSISË E DERI TE KONFLIKTI (VITI 1991–2001)

Kjo pjesë e raportit fokusohet në zhvillimin e përgjithshëm politik dhe ate të sigurisë në Maqedoni, gjatë kohës së periudhës së parë të analizës, periudhës në mes të vitit 1991 dhe 2001. Pjesa e parë i përket gjendjes së përgjithshme gjatë kohës së kësaj periudhe, me theks të veçantë në dy sfera të veçanta të cilat janë karakteristike për politikën maqedonase, për kohën e të njejtës: përkrahja nga populli gjatë kohës së formësimit të shtetësisë dhe perspektiva e përfundimit të formësimit të institucioneve. Ai gjithashtu shfaq të shikuarit mbi sektorin e sigurisë dhe kërcënimet e sigurisë gjatë kohës së kësaj periudhe. Pjesët tjera fokusohen në analizën e institucioneve dhe sektorëve, duke theksuar zhvillimin e institucioneve dhe politikën e sektorit të sigurisë.

### 1.1 Gjendja e përgjithshme

Periudha e parë e politikës paskomuniste të Maqedonisë është shënuar me dy ngjarje më me rëndësi të cilat paraqesin pika kyçë. E para është ndarja nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ) dhe shpallja e pavarësisë nga plebishi i shtator të vitit 1991 - shënim i fillimit të politikës paskomuniste dhe suverenitet për Maqedoninë. E dyta është konflikti në mes të forcave të armatosura maqedonase dhe grupeve të armatosura shqiptare, në vitin 2001, i cili kishte ndikim të fuqishëm mbi konceptet e suverenitetit dhe të demokracisë në Maqedoni, si dhe në sektorin e sigurisë dhe në situatën më të gjërë të sigurisë, duke përfshirë kërcënimet dhe nevojën për reforma. Pas pavarësisë ndodhën shumë ngjarje, gjatë së cilës faktori vendosës kishte mundësi të zgjedh në cilin drejtim do ta orientojë politikën maqedonase para vitit 2001: zgjedhje të cilat i përkasin institucioneve, si miratimi i Kushtetutës së re në nëntor të vitit 1991, ndryshimi i ligjeve zgjedhore, i politikës së jashtme, vendosja e marrëdhënieve diplomatike me organizatat ndërkombëtare dhe vendet fqinje, si dhe zgjedhje të cilat i përkasin politikës vendore - reformat në sektorin publik, privatizimi, rekonstruimi ekonomik dhe pakicat etnike. Sipas ngjarjeve të kaluara mund të bëjmë një rishikim kritik të kësaj periudhe dhe ta vlerësojmë ndikimin e saj mbi periudhat që pasojnë pas saj, si dhe rikthim në zhvillimin e tanishëm të politikës maqedonase në përgjithësi, si dhe ndikimi mbi sektorin e sigurisë.



Themelimi i shteti të pavarur në vitin 1991 është ngjarje kryesore për politikën dhe historinë maqedonase. Para vitit 1991, shtetësia maqedonase ishte e kufizuar në kuadër të federatës jugosllave, si një nga gjashtë njësítet përbërëse federale, por ajo nuk posedonte suverenitet dhe pavarësi të vërtetë. Andaj, për elitën politike, si dhe popullatën në tërësi, themelimi i shtetit të pavarur paraqiste ngjarje historike e përcjellur me entuziazëm të madh, gjë që mund të nxirrej nga shkalla e përkrahjes publike përgjatë kohës së referendumit për pavarësi, të mbajtur më 8 shtator të vitit 1991, në të cilën u deklaruan 95% nga ata të cilët e përkrahën pavarësinë.<sup>1</sup> Duhet të theksohet se referendumi për pavarësi ishte i bojkotuar nga ana e pjesës më të madhe të popullatës etnike shqiptare në Maqedoni, që edhe pse ndikonte në përfundimin pozitiv të referendumit, megjithatë nxiti disa pyjetje mbi legjitimitin e shtetit të ri të formuar në mes të grupeve të ndryshme etnike. Shqiptarët ishin të brengosur për statusin që do ta kishin në shtetin e ri të formuar maqedonas, duke u frikësuar që të mos trajtohen si "pakica", pasi që me decenie ishin të trajtuar si nacionalitet në RSFJ. Kon sensusi në mes të grupeve (etnike dhe të tjera) në shoqëri, rreth asaj se si është "populli" dhe çka është "shteti", është njëri nga parakushtet themelore për themelimin e demokracisë, sipas më shumë ekspertëve për demokraci<sup>2</sup>. Nga andej, mossuksesi që të përfshijë të gjitha grupet etnike gjatë themelimit të shtetit, duket si shansë e lëshuar për themelimin e të nejtës në bazë të konsensusit fillestare, i cili nuk ishte me rëndësi për elitën politike deri në vitet që pasonin më vonë.

Dy aspekte nga gjendja e shtetit të ri janë me rëndësi të veçantë për analizën e tanishme dhe do të elaborohen më detajisht: entuziazmi i popullit - i cili u rrit në një përkrahje të fuqishme për ndërtimin e shtetit dhe për reformat, si dhe mungesa e historisë të shtetësisë e cila u shpie në një trashëgimi të vogël institucionale, duke pasur parasysh se komunizmi ishte i diskredituar si ideologji oficiale.

<sup>1</sup> Komisioni shtetëror zgjedhorë. Rezultatet e zgjedhjeve, viti 1990-2000. Mund ta gjeni në: <http://www.sec.mk/Default.aspx?tabid=855>

<sup>2</sup> D. Rustow, "Transitions to Democracy: Towards a Dynamic Model" në *Comparative Politics*. Vëllimi 2, nr.3, (prill, viti 1970) dhe R. Dahl, *Polyarchy: Participation and Opposition*. (New Haven: Yale UP, viti 1971).


### 1.1.1. Përkrahja e popullit për themelimin e shtetit

Si dhe shtetet tjera të cilët dolën nga komunizmi në fillimin e viteve të nëntëdhjeta, populli maqedonas me pritje të mëdha hyri në periudhën e tranzicionit paskomunist drejt demokracisë. Në rastin e Maqedonisë, ajo ishte madje edhe si rezultat i entuziazmit për krijimin e shtetit të pavarur. Duke pasur parasysh se sot kemi trup apatik zgjedhor dhe qeveri joaktive, duket se periudha nga vitet e hershme të nëntëdhjeta paraqiste mundësi për implementimin e reformave të fuqishme në sektorin publik, nga të rregulluarit e tregut, e deri te reformat në sektorin e sigurisë. Kur pjesëmarrja për zgjedhje u ngrit në 70% nga trupi votues dhe partitë politike mundeshin të tubonin qindra mijë qytetarë nëpër qendrat e qyteteve, duhej vetëm një udhëheqje e guximshme politike, me programe të fuqishme për reforma, dhe do të arrihej shumë, mirëpo një mundësi e tillë u lëshua. Nga pikëvështrimi i përfundimit<sup>3</sup>, vitet e hershme të nëntëdhjeta dhe disa kabinete të para demokratike, kishin mundësi të veçanta të sjellin vendime me të cilat do të përcaktonin rrugën e pasardhësve të tyre, mirëpo udhëheqja politike maqedonase, në këtë periudhë, nuk mund të thuhet se ishte mjaftueshmë e guximshme. Përpjekjet e buta për privatizim shpien deri tek rekonstruimi i pasukseshmë i ekonomisë socialiste dhe rënie e standardit të jetësës së popullatës<sup>4</sup>, kurse administrata publike mbeti virtualisht e pandryshuar që nga koha e komunizmit.<sup>5</sup> Në vend që ta ndjek shembullin nga mbetja tjetër e regjionit, elita politike u morr me politikëna nacionaliste, duke humtuar dhe zbuluar historinë e cila ishte e ndaluar gjatë kohës së komunizmit, duke harxhuar, gjatë kësaj, kapitalin politik për problemet simbolike, siç ishte problemi rreth emrit me Greqinë, pa iu përkushtuar zbatimit të mëtutjeshmë të reformave të domosdoshme dhe të vendosjes së marrëdhënieve më të mira me institucionet ndërkombëtare, siç ishin NATO

<sup>3</sup> Paul Pierson, *Politics in Time: History, Institutions, and Social Analysis*. (Princeton: Princeton University Press, viti 2004)

<sup>4</sup> Bruto prodhimi vendor i Maqedonisë kishte rritje negative deri më vitin 1996, dhe deri në fund të vitit 1996 ekonomija maqedonase nuk i arinte shkallën e rritjes nga periudha e para viteve të nëntëdhjeta. *Bruto prodhimi vendor, viti 1990-2000*. Enti shtetëror për statistik, viti 2002 ([http://www.stat.gov.mk/pdf/soopstenija\\_28.05.2002/SOOP3.1.2.02.pdf](http://www.stat.gov.mk/pdf/soopstenija_28.05.2002/SOOP3.1.2.02.pdf))

<sup>5</sup> Strategjia e parë publike për reformat në administratën publike ishte miratuar në vitin 1999. *Reformat në administratën publike*. Qeveria e Republikës së Maqedonisë. ([http://rja.gov.mk/files/documents1/Strategjija\\_RJA\\_mk.pdf](http://rja.gov.mk/files/documents1/Strategjija_RJA_mk.pdf))



dhe UE.<sup>6</sup> Politika e tillë, jo vetëm që rezultonte me mundësi të shumta të lëshuara dhe harxhim të kotë të kapitalit politik dhe përkrahjes nga publiku, por, në fundin e viteve të nëntëdhjetë, elita ballafaqohej edhe me një ekonomi të pasuksesshme, me demokraci të dobët, me padëgjueshmëri te popullata dhe me kapital të pamjaftueshëm politik për zbatimin e reformave të mëtutjeshme.

### 1.1.2. Varshmëria nga përfundimi dhe krijimi i institucioneve

Aspekt tjetër problematik nga vitet e hershme të tranzicionit është mungesa e traditës demokratike e shtetërore dhe përvjösës. Shteti maqedonas dhe demokracia filluan të ndërtohen nga zeroja. Praktika e zakontë ishte e huazuar nga modelet e shteteve të tjera, kryesisht nga evropa perëndimore. Kushtetuta, sistemet politike dhe zgjedhore, si dhe zgjidhjet e shumta ligjdhënëse, ishin të kopjuara nga shtetet e tjera (praktikë e cila çdo herë aplikohet, veçanërisht tvining projektet e mëvonshme të UE), me marrje të dobët parasysh të zbatueshmërisë së tyre dhe kapacitetit të shtetit për implementimin e tyre. Shumë prej tyre (Kushtetuta, sistemi zgjedhor etj.) më vonë u treguan si problematike dhe u paraqit nevoja për reforma të të njejtat.

Periudha pas vitit 1991 gjithashtu i shënoi hapat e parë të Maqedonisë në politikat demokratike. Me rënien e komunizmit dhe çthurjen e federatës jugosllave, shteti i ri maqedonas ishte i themeluar mbi principe demokratike, siç ishte edhe e shkruar në Kushtetutën e vitit 1991. Kjo rezultonte me zgjedhje të lira, në të cilën u kyçën më shumë parti dhe gjatë së cilës kohë popullata mund të votonte për kandidatë nga parti të ndryshme. Edhe pse fragmentimi politik i caktuar ishte i pashmangshëm, me siguri, duke i falemnderuar sistemit zgjedhor të shumicës i cili ishte i ruajtur nga koha e komunizmit, Maqedoninë nuk e gjeti optimi dhe fragmentimi në parti politike si disa shtete paskomuniste. Dy partitë më të mëdha në zgjedhjet e vitit 1990 e mbajtën udhëheqjen në dy deceniet e ardhshme (Lidhja Social-demokrate e Maqedonisë- LSDM, e cila është trashëgimtare e ish Lidhjes së Komunistëve të Maqedonisë, dhe Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas - OBRM-PDUKM (VMRO-DPMNE)). Situata në trupin zgjedhor shqiptar është e llojit tjetër, sepse partitë politike të cilat dominuan në skejnën politike në vitet e nëntëdhjetë (Partia për Prosperitet Demokratik – PPD

<sup>6</sup> Maqedonia vendosi mardhënie diplomatike me UE qysh në vitin 1996, menjëherë pas marëveshjes preleminare në mes të Maqedonisë dhe Greqisë, e cila u nënshkrua në dhjetorë të vitit 1995, nën patronatin e KB.

dhe Partia Demokratike Popullore - PDP) u zhdukën pas konfliktit të vitit 2001 dhe partitë e reja shqiptare e fituan përkrahjen e shqiptarëve etnik në Maqedoni (Bashkimi Demokratik për Integrin - BDI dhe Partia Demokratike Shqiptare- PDSH). Edhe pse në zgjedhjet nuk ishte vërejtur mashtrimi i hapur, ata asnjëherë nuk i plotësuan standardet demokratike perëndimore në raport me incidentet e kohëpaskohshme të dhunës, votimit me autorizim, votimit familjar dhe parregullësive të tjera<sup>7</sup>. Elementet tjera të demokracisë ishin gjithashtu në nivel jo të duhur: shoqëria qytetare, edhe pse asnjëherë e përnxitë, gjithashtu nuk kishte ndikim dhe nuk pranohej nga publiku i gjërë si mjet për kontrollimin e punës së Qeverisë. Mediumet shpesh ishin nën ndikimin politik, nëse jo edhe direkt të kontrolluara, raste të cilat edhe sot janë prezente, çka sjell deri tek përfundimi brengosës për mungesën e trendit pozitiv të konsolidimit të demokracisë maqedonase.<sup>8</sup>


### 1.1.3. Siguria dhe kërcnimet e sigurinë

Sektorit të sigurisë, në përjashtim të ushtrisë, nuk iu kushtua kujdes i veçantë dhe ishte i trajtuar si mbetje nga administrata publike, me disa ndryshime artificiale të miratuara në atë periudhë. Ushtria mbeti tjetëfare pas tërheqjes së Armatës Popullore Jugosllave (APJ) nga territori i Maqedonisë, Maqedonia nuk kishte armatë. Nga atje, krijimi i armatës u bë prioriteti më i lartë, sepse paraqiste element me rëndësi për themelin e suverenitetit të plotë dhe kontrollin e territorit, si dhe nevojë në kohë dhe në regjion ndaj jostabilitetit të shprehur dhe kërcnimit mbi sigurinë. Armata e Republikës së Maqedonisë (ARM) ishte krijuar nga përfaqësuesit e APJ dhe forcave tjera të sigurisë të cilat iu bashkangjiten ARM. Në ndërkohë, kryetari Kiro Gligorov i ftoi trupat preventive të KB të patrollojnë nëpër kufitë e ri maqedonas, së bashku me ARM. Trupat e KB qëndruan në Maqedoni deri në vitin 1999.

Në arenën e brendshme politike, rreziku më i madh mbi sigurinë në këtë periudhë i përket marrëdhënieve ndëretnike dhe baraspeshës në mes të

<sup>7</sup> UNDP. "I will vote by myself, thank you" në Gjininë në Evropë dhe ZND. Mund ta gjeni në: <http://europeandcis.undp.org/gender/show/30521F9A-F203-1EE9-B6D7F1FC3C89B37D>

<sup>8</sup> Madje edhe në vitin 2008, vetëm përafërsisht 16% nga qytetarët maqedonas kishin besueshmëri në institucionet e shoqërisë qytetare dhe në mediumet, në krahësim me 38% të cilët kishin besueshmëri në ushtri dhe 51% të cilët kishin besueshmëri në bashkësitetet. „Galup Balkan monitor: Qasje dhe percepcione – votat e vendeve ballkanike”, viti 2008. <http://www.balkan-monitor.eu/index.php/dashboard/70-of-macedonian-albanians-supported-ohrid-agreement/>



dy bashkësive më të mëdha etnike në Maqedoni: Maqedonasve dhe Shqiptarëve. Marrëdhëniet në mes të Maqedonasve etnik dhe Shqiptarëve etnik dukshëm u keqësuan gjatë kohës të decenies së parë pas pavarësisë. Edhe përskaj pjesëmarrjes të partive politike shqiptare në qeveritë e koalicionit, nga viti 1992 e këndeje, shumica e kërkesave të pakicës shqiptare të cilat i përkisnin rritjes së prezencës në administratën publike, përdorimi ofisial i gjuhës shqipe dhe arsimi i lartë në gjuhën shqipe, si dhe ndryshimet kushtetuese me të cilat Shqiptarët do të ishin pranuar si "popull përbërës" ose "popull themelues" të shtetit maqedonas, nuk u morën parasysh. Numri i madh i incidenteve të dhunës gjatë kohës së nëntëdhjetave ishin tregues për tensionet në mes të dy bashkësive, në mes të vetë popullatës etnike shqiptare, si dhe i institucioneve shtetërore. Në vitin 1995, policia, duke zbatuar dhunën, ndërpreu manifestimin me rastin e themelimit të Universitetit të Tetovës në Reçisë të Vogël, dedikuar për të studiuar në gjuhën shqipe, kurse në vitin 1997 njësitë policore u ndeshën me masat e demonstruesve në qendrat në Tetovë dhe Gostivar, pasi që flamujtë shqiptarë të cilët ishin të vendosura para komunave të qyteteve ishin të larguara nga ana e polisë. Këto, si dhe incidentet tjera më të imëta, ishin tregues jo vetëm për marrëdhëniet e dobëta ndëretnike, por edhe për faktin se organet e sigurimit shtetëror nuk posedojnë kapacitete të mjaftueshëm për ballafaqim me situata specifike të sigurisë dhe për veprime preventive, përkundrazi, akcionë i njësive policore dhe atyre speciale në mënyrë plotësuese e keqësuan situatën.

Nga jashta, rreziqet më të mëdha mbi sigurinë për Maqedoninë vinin nga fqinjësia e saj. Shtetësia e paradokohshme e Maqedonisë ishte e provokuar nga shumë anë: Greqia kundërshtoi për përdorimin e emrit të Maqedonisë dhe e bllokonte pranimin ndërkombëtarë të Maqedonisë me atë emër, por gjithashtu e bllokonte edhe anëtarësimin e Maqedonisë në shumë organizata ndërkombëtare deri në dhjetor të vitit 1995, kur Maqedonia dhe Greqia nënshkruan marrëveshje të përkohëshme, andaj Maqedonia fitoi mundësi për vendosjen e marrëdhënieve ndërkombëtare nën referencën e IRJM. Bullgaria e provokonte ekzistimin e kombit dhe gjuhës maqedonase deri në vitin 1999, kur u nënshkrua marrëveshja ndërreveritare për gjuhën maqedonase dhe bullgare dhe ajo pyetje në mes të dy shteteve u zgjidh. Kufiri ndërkombëtar në mes të Maqedonisë dhe Sérbisë nuk ishte i shënuar deri në vitin 2003, e të mos flasim për natyrën më rozë të të njëjtë kufi me Kosovën dhe mossuksesin e institucioneve maqedonase të vendosin kontroll të tërësishme mbi territorin e shtetit (me çka filloj konflikti në vitin 2001, kur


ishte kidnapuar ekipi i gazetarëve, i cili hulumtonte marrjen e kontrollit mbi fshatin më në Veri të kufirit me Kosovën, nga ana e forcave paraushtarake). Këto kërcënime të sigurisë nuk ishin të një natyre të zakonshme luftarake, por paraqisin kërcënim për identitetin dhe bashkësinë (nga aspekti etnik). Deri sa disa parashikonin konflikte të armatosur me Greqinë dhe Bullgarinë ose Sérbinë/Kosovën, qëndrimet e tyre për Maqedoninë ishin kuptuar seriozisht dhe deri në një shkallë të lartë e formuan politikën e jashtme (dhe të mbrendshme) të Maqedonisë, të pasuar me pasiguri të madhe në lidhje me shtetësinë maqedonase dhe simbolet e saja, e cila u mbajt edhe pas përpjekjeve të bëra për tejkalimin e tyre. Madje, edhe sot mosmarrëveshja e pazgjidhur rrëth emrit me Greqinë paraqet kufizim për politikën e jashtme maqedonase, e edhe më shumë për reformat në sektorin e sigurisë, si dhe arsyen e vetme për aplikimin e pasukseshëm të Maqedonisë për hyrje në NATO. Pasuria provokonte mosbeueshmëri te fqinjët, e kjo si e tillë e pri shi bashkëpunimin regional gjatë kohës së embargos nga ana e Greqisë dhe embargos ndaj Sérbisë, të cilat i shkaktuan dëm ekonomisë maqedonase, njësoj si dhe pranimi ndërkombëtar i pazgjidhur dhe prolongimi i anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Rezultati nga politika të cilën e udhëheqnin tre kabinetet qeveritare (me bindje të ndryshme ideologjike), gjatë kohës së decenies së parë pas pavarësisë, ishte shteti i ri dhe i dobët i cila para do kohësh ishte shkëputur nga regjimi komunist, në vetë pragun e procesit të demokratizimit, shtet me institucione të dobëta dhe jo të konsoliduara, me ekonomi të shkatëruar dhe shoqëri të polarizuar të ndarë mbi baza etnike dhe politike. E gjith kjo solli deri te një gjendje e fuqishme paskomuniste (pothuajse postautoritative) dhe parae konfliktit socio-politike dhe të sigurisë.

## 1.2. Analiza e institucioneve/sektorëve

### 1.2.1. Armata

Të hartuarit e shpejtë të sektorit të sigurisë në periudhën e fillimit të pavarësisë tregoi lëshime serioze dhe mungesë të elementeve të cilat ftojnë në zgjidhje urgjente. Siç është tanimë e theksuar, si nga territoret e ish republikave të tjera jugosllave, APJ u tërroq edhe nga Maqedonia, prandaj u paraqit nevoja për krijimin e një armate të re. Në mes të viteve 1991-1992, kur kryetari i ri i zgjedhur i Maqedonisë, Kiro Gligorov, bashkëbisedonte



me sekretarin federal për mbrojtje popullore të RSFJ, Bllagoja Axhiq, për tërheqje të qetë të APJ nga territori i Maqedonisë, njësitë tjera të mbeturatë cilët kryesisht përbëhen nga personeli sérb dhe malazez, nga ana e institucioneve të sigurisë, elitës politike dhe popullatës, konsideroheshin kërcënim potencial për pavarësinë dhe suverenitetin e ri të nxënë të Maqedonisë, e jo si pjesë e sektorit maqedonas të sigurisë. Më tutje, si edhe nga vetë mbetja tjetër nga ish Jugosllavia, APJ mori bukvalisht gjithçka çka mund të merrej, duke përfshirë paisje, armë, materiale, rezerva etj., për të lënë infrastrukturën e gjymtuar të shërbej si themel për ndërtimin e armatës së re maqedonase. Themelimi i Armatës të Republikës së Maqedonisë (ARM) filloj me shpalljen e Ligjit për mbrojtje në vitin 1992, e pasuar me marrjen e kontrollit kufitar dhe kontrollit mbi objektet ushtarake në Maqedoni, në 27 mars të vitit 1992, pikërisht ashtu siç theksohej në marrëveshjen e arritur në mes të kryetarit Gligorov dhe gjeneralit të APJ, Nikolla Uzellac. Regrutët e parë të ARM arritën në barakat në prill të vitit 1992, duke marrë kontrollin mbi kufitë maqedonas nga ana e policisë.<sup>9</sup>

Kapacitetet njerëzore dhe teknike të ARM të posakrijuar ishin dëshpëruese të vogla. Edhe pse ARM oficjalisht e mori kontrollin mbi kufitë maqedonas, në periudhën fillestare, derisa regrutët kalonin nëpër trajnimin bazik, kufitë ruheshin nga profesionistë, ushtarë të paguar nga njësitë rezerve. KB dërguan mision preventiv në Maqedoni - UNPREDEP, forcat e të cilat ndihmuan ARM gjatë patrollimit nëpër kufi, deri në vitin 1999. Nevojitej kohë të ndërtohej armata e cila fillonte nga nga zero, i tillë ishte edhe rasti me ARM, kapaciteti dhe potentiali i së cilës ishte më i madh në vitet e nëntëdhjetës. Shumica e oficerëve ishin ish oficerë të APJ, të cilët ishin trajnuar në suaza të të njëjtës, dhe nga andej edhe miratimi i konceptit të ri për ndërtimin e Armatës nuk ishte hap më i mirë. Në çdo rast, që nga vetë fillimi qëllimi ishte që të krijohet një armatë moderne dhe efikase, e cila do të ishte shqëlyqeshëm e integruar në mekanizmat kolektiv të sigurisë në regjion e më gjerë. Rezultatet nga këto përpjekje ishin të theksuara në vitet e mesme dhe të vonshme të nëntëdhjetave, kur në nëntor të vitit 1995 Maqedonia iu bashkangjitet Partneritetit për paqë (PPP), çka shënon lidhje më të afërt me NATO dhe ndihmë gjatë implementimit të reformave mbi sigurinë dhe mbrojtjen, si dhe pjesëmarrje dhe nikoqirlliëk në stërvitjet ushtarake regionale dhe ndërkombëtare, të cilat u mbajtën në vitin 1996 dhe 1997.<sup>10</sup>

<sup>9</sup> Historia e ARM. Ministria e mbrojtjes e RM. Mund ta gjeni në:

<http://www.morm.gov.mk:8080/morm/mk/ARM/History/History1.html>


<sup>10</sup> Historia e ARM. Ministria e mbrojtjes e RM.

Në këtë periudhë, Armata ishte institucion i ri dhe nuk ishte direkt i kyçur në sigurimin e sigurisë dhe të interaksionit me popullatën. Nga andej, populata nuk kishte ndonjë fotografi negative ndaj ARM, në pikëpamje me atë se a është e korruptuar apo opresive, kurse disa burime e tregojnë edhe shkallën e besueshmërisë të popullit në Armatë. Disa skandale rreth posedimit të apartmaneve ushtarake dhe furnizimit me armë u paraqitën në mediume, por në krahasim me skandalet për korruptimin e policisë, partive politike dhe disa përfaqësuesve qeveritar, ARM u tregua si relativisht transparente dhe si një institucion i besueshëm.

## 1.2.2. Policia

Në vakoumin e sigurisë nga vitet e hershme të pavarësisë, policia ishte faktori kryesor për sigurinë në Maqedoni. Para marrjes së kontrollit mbi kufitë nga ana e ARM në vitin 1992, policia ishte përgjegjëse për kontrollin e tyre, nga shpallja e pavarësisë në vitin 1991, si plotësim i kryerjes së detyrimeve të regullta policore dhe sigurimin e sigurisë së popullatës. Gjatë kohës së kësaj periudhe, policia ishte tepër e zënë me plotësimin e këtyre detyrimeve, duke pasur parasysh kapacitetin e kufizuar të njerëzve dhe teknikës (në këtë periudhë policia përbëhej vetëm nga 6000 mijë përfaqësues). Këto përpjekje të hershme të policisë për mbrojtjen e kufive dhe sigurimin e sigurisë të shtetit të ri të pavarur maqedonas, e ngriti policinë në faktor me rëndësi politike dhe të sigurisë në atë kohë.

Atributi patriotik të cilën e meritoi policia gjatë kohës së periudhës fillestare pas pavarësisë, nuk u ngrit si nevojë për reforma të të njejtës. Për dallim nga disa shtete tjera paskomuniste, Maqedonia nuk vazhdoi me procesin e çarmatimit të armëve policore nga komunizmi, edhe pse ekzistonin disa përpjekje për reforma në polici. Deri më vitin 1995, puna e policisë ishte e rregulluar me Ligjin për punë të brendshme i cili datonte që nga koha e Jugosllavisë. Nga mesi i viteve të nëntëdhjetës, policia ishte pjesë e trajnimeve të regullta dhe intenzive për respektimin e të drejtave të njeriut dhe zotërimin e ligjit, shpesh e implementuar nga ana e organizatave ndërkombëtare. Këto trajnime kishin për qëllim t'i përmirësojnë marrëdhëniet në mes të policisë dhe sektorit të organizatave ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare në Maqedoni i cili ishte në rritje. Efikasiteti i trajnimeve të tillë dhe i përpjekjeve për reforma ishin diskutabile, duke pasur parasysh natyren e tyre të rastësishme dhe mungesën e aktiviteteve plotësuese. Deri në vitet e vona të nëntëdhjetës, raportet e regullta të Avokatit të Popullit



vërtetuan shkelje të numërtat të drejtave të njeriut nga ana e policisë, edhe përskaj përpjekjeve për trajnimin e policisë lidhur me të drejtat e njeriut.<sup>11</sup> Gjatë kohës së decenies së fundit, numri i përfaqësuesve të policisë u zmadhua, por regrutimi shpesh nuk ishte transparent dhe shpiante deri te fenomeni i politizimit të njëjtës, çka e nxiu punën e saj dhe i varrosi përpjekjet për reforma në vitet që pasonin.

### 1.2.3. Shërbimet zbuluese

Me Ligjin për punë të brendshme nga viti 1995 ishin të parashikuara reforma në sektorin e zbulimit, i cili në kohën e komunizmit vepronë si pjesë e policisë. Agjencioni për zbulim (AZ) ishte themeluar si organ i veçant nga Drejtoria për siguri dhe kundërzbullim (DSK), organ për kundërzbullim i cili gjatë kohës së RSFJ funksiononte në kuadër të Ministrisë së punëve të mbrendsheme. Agjencioni për zbulim ishte nën autoritetin e dyfishtë, të presidentit dhe të Qeverisë, kurse DSK nuk ishte nën autoritetin e presidentit. Ligji i përfshinte principet themelore të mbikqyrjes demokratike të punës së shërbimeve të zbulimit. Komiteti parlamentar mbeti përgjegjës për kontrollimin e punës së DSK dhe AZ. Komiteti pranon raporte vjetore për punën e shërbimeve të zbulimit dhe, nëse ka nevojë, Kuvendi vendos se të njëjtat a duhen të shqyrtohen në mbledhje plenare. Zbulimi ushtarak nuk ishte i kyçur në DSK dhe AZ dhe në mes tyre nuk ishte vendosur bashkëpunimi në nivel operativ. Ndarja e operacioneve ishte e mundshme vetëm në nivel më të lartë ekzekutiv. Si trashëgim nga koha e komunizmit, të gjitha shërbimet zbuluese shikoheshin si jo të besueshëm nga ana e popullatës më të gjërë, çka mund të plotësohet edhe me atë se shumë pak nga përpjekjet për reforma ishin të shpallura dhe pak ishte bërë në lidhje me përmirësimin e pasqyrës së këtyre institucioneve para syve të publikut. Në kohën e pjesës më të madhe të tranzicionit të hershëm, Maqedonia nuk ishte e kyçur në reformat e reja, për dallim nga mbetja prej sektorit të sigurisë.

Në nivelin ekzekutiv, Kushtetuta e emëroi presidentin për komandant kryesor të forcave të armatosura, kurse drejtimi i Armatës dhe i policisë mbeti përgjegjësi e Qeverisë, më saktësisht e Ministrisë për mbrojtje dhe Ministrisë për punë të brendshme. Sistemi politik në Maqedoni është i përzier, por kryesisht fuqinë ekzekutive e ka Qeveria dhe vendimet kryesore

<sup>11</sup> Raportet vjetore për punën e Avokatit të Popullit. Avokatii Popullit i Republikës së Maqedonisë. Mund ta gjeni në: <http://www.ombudsman.mk/default.aspx?clid=104&Lan=MK>

politike në raport me sigurinë bien dhe realizohen përmes institucioneve qeveritare - ministrike dhe agjensioneve. Kryetari është komandant kryesor i forcave të armatosura, por ndikimi i tij mbi politikën është i kufizuar. Gjatë kohës së kësaj periudhe veprojnë më shumë institucione qeveritare, por Qeveria vonohet me miratimin e dokumenteve strategjike për siguri nationale të cilat duheshtë të prezantojnë përcaktime për reformat dhe zhvillimin e politikës në sektorin e sigurisë. Në degën ligjdhënëse, Kuvendi është institucion përgjegjës për miratimin e legjislativës, si dhe i mbikqyrjet demokratike të punës të faktorëve të sigurisë. Baza e legjislativës është prezentuar në Ligjin për mbrojtje dhe Ligjin për punë të brendshme dhe, në funksion të plotësim të njëjtës, ishin të miratuara edhe disa ligje për rregullimin e sektorit të sigurisë, si Ligji për kalimin e kufirit shtetëror dhe për levizje në rripin kufitar, Ligji për mbrojtje të dhënavë personale, kurse me ndryshimin e pushtetit në vitin 1998 (nga qeveria e udhëhequr prej LSDM, në qeveri e udhëhequr prej OBRM-PDUKM) edhe Ligji për veprim me dosjet për personat e udhëhequr nga Shërbimi për siguri shtetërore, me të cilën ishte e mundësuar qasja deri te dosjet e të gjithë të interesuarve.

Periudha e parë nga analiza, vitet në mes të shpalljes së pavarësisë dhe filimit të konfliktit, është e shënuar me karakteristika politike paskomuniste dhe parae konfliktit. Decenia e parë dëshmon për themelimin e institucioneve themelore shtetërore dhe praktikave demokratike pas rënies së komunizmit. Kjo periudhë, gjithashtu, dëshmon edhe për themelimin e Armatës maqedonase, si një nga shtyllat kryesore të sektorit të sigurisë në Maqedoni, si dhe i përpjekjeve të para për transformimin e mbeturinave nga sektori i sigurisë në faktorin demokratik të sigurisë, edhe pse vetë reforma në tërësi ishte e kufizuar.



## PERIUDHA 2: VITI 2001 – 2008: PREJ OHRIT E DERI NË BUKURESHT

### 2.1. Situata e përgjithshme

Konflikti etnik në mes të forcave maqedonase të sigurisë dhe kryengritësve shqiptar etnik i cili zgjati gjashtë muaj, gjatë kohës së pranverës dhe verës, në vitin 2001, ishte ngjarje e shënuar e cila nxiti rishikimin e ideve mbi të cilat mbështetet shtetësia dhe politika maqedonase gjatë kohës së viteve të nëntëdhjetë. Kjo paraqiste kërcënim më të madh për sigurinë maqedonase nga koha e pavarësisë e këndeje. Policia maqedonase, Armata, njësitë speciale, shërbimet e zbulimit dhe njësitë paraushtarake të reja të krijuara nga ana maqedonase dhe ajo shqiptare ishin të kyçura në konflikt - disa prej tyre madje edhe për herë të parë merrnin pjesë në luftë. Mungesa e stabilitetit dhe e sigurisë e cila rrjedhë nga baraspesha etnike ishin të vërejtura së bashku me nevojën për intervenim më të madh dhe për reforma kushtetuese. Fundi jo bindës i konfliktit dhe nevoja për ndërmjetësim të jashtëm sollën deri te përfundimi se forcat maqedonase të sigurisë<sup>12</sup> nuk posedojnë kapacitet të mjaftueshmër përluftë strategjike dhe zgjidhje e ndërmjetësim të qetë të konfliktit. Nga atje rrjedh se Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO), e ndërmjetësuar nga UE dhe SHBA, e cila u nënshkrua më 13 gusht të vitit 2001 nga liderët e katër partive më të mëdha politike në Maqedoni (LSDM, OBRM-PDUKM, PDSH dhe PPD), dedikuar për zbatimin e reformave më të rëndësishme në sektorin publik: arsimi, decentralizimi, përdorimi i gjuhës dhe sektori i sigurisë.

#### 2.1.1. Marëveshja Kornizë e Ohrit dhe reformat postkonflituze

Nuk mund të thuhet se në mesin e popullit ekzistonte nevojë e madhe për këto reforma, përvèç nevojës shumedecenie te Shqiptarët etnik për përfshirje më të madhe në administratë publike. Reformat nga Marëveshja e Ohrit të cilat i përkasin sektorit publik ishin të imponuara nga jashtë, edhe pse një pjesë e elitës politike ishte e vetëdijshme për nevojën e të


<sup>12</sup> Njësitë e ARM edhe më parë morrën pjesë në misione ndërkombëtare të paqës, por asnjëherë nuk ishin kyçur në luftë. Pajisja dhe armët e ARM dhe të policisë maqedonase ishin të vjetruara, pajisjet dhe armatimi ishin huazuar gjatë kohës së konfliktit të shkurtër.

njejtave. Përzierja nga jashtë në procesin e vendosjes së reformave vazhdoi (e ndoshta madje edhe u zmadhua), me synime serioze të theksuara të Maqedonisë përluftës së Unionin Evropian dhe NATO, andaj implementimi i standardeve nga Marrëveshja e Ohrit ishte e kyçur në kriteriumet politike sipas të cilave vlerësohej përparrimi i Maqedonisë. Nga njëra anë, kjo e ndihmonte zbatimin e reformave, duke i falemnderuar ndjekjes që vie nga ana e kushtëzimit<sup>13</sup>, por nga ana tjeter, kompetencat e UE mbi reformat e para para me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, ndikuan që elita politike vendore ta konsiderojet marrëveshjen si të imponuar, në vend se si një dokument kushtetues i arritur me marrëveshje nga ana e liderëve politik vendor. Në vitin 2008, tetë vite pas nënshkrimit të marrëveshjes, vetëm rreth 44% nga popullata maqedonase e konsideronte Marrëveshjen Kornizë të Ohrit si zgjidhje të mirë për problemet etnike në Maqedoni (edhe pse, kur bëhet fjalë për Shqiptarët, kjo përqindje arrinte 70%).<sup>14</sup>

Marrëveshja Kornizë e Ohrit ishte e vendosur mbi principin e përfshirjes së drejtë në administratën publike, çka nënkuption punësim të theksuar etnik në institucionet publike, me qëllim që të plotësohet përqindja, e arritur përmes marrëveshjes, i të punësuarve, me përkatesi nga bashkësítë më të vogla etnike, në administratën publike. Kjo duhej të sjellë deri te një përfshirje më të madhe të përfaqshuesve nga bashkësítë më të vogla etnike. Në sektorin e sigurisë kishte nevojë për reforma më të rëndësishme, prandaj institucionet ndërkombëtare i ndihmuani Qeverisë maqedonase gjatë zbatimit të reformave në polici dhe Armatë, e cila bëri përpjekje, së bashku me UE, NATO dhe OBSE, t'i zbatojë reformat në polici dhe në Armatën e Maqedonisë. Restruktuimi i Armatës u krye sipas standardeve të NATO-s, si pjesë e përpjekjeve për integrim. Ajo nënkuptione racionalizimin e paisjes sipas standardeve efikase të NATO-s, e gjithashtu solli edhe deri te profesionalizimi i ARM në vitin 2004. Në periudhën në mes të vitit 2002 dhe 2007, më aktivisht u zbatuan reformat në sferën e mbrojtjes, sipas Strategjisë nationale për anëtarësim në NATO, dhe u miratuan një numër dokumentesh juridike dhe strategjike në sektorin e sigurisë, duke kyçur edhe Konceptin për siguri nationale, Doktrinën mbrojtëse dhe ndryshimet në Ligjin për mbrojtje nga

<sup>13</sup> Përfshirje më të madhe në administratën publike, çka nënkuption punësim të theksuar etnik në institucionet publike, me qëllim që të plotësohet përqindja, e arritur përmes marrëveshjes, i të punësuarve, me përkatesi nga bashkësítë më të vogla etnike, në administratën publike. Kjo duhej të sjellë deri te një përfshirje më të madhe të përfaqshuesve nga bashkësítë më të vogla etnike. Në sektorin e sigurisë kishte nevojë për reforma më të rëndësishme, prandaj institucionet ndërkombëtare i ndihmuani Qeverisë maqedonase gjatë zbatimit të reformave në polici dhe Armatë, e cila bëri përpjekje, së bashku me UE, NATO dhe OBSE, t'i zbatojë reformat në polici dhe në Armatën e Maqedonisë. Restruktuimi i Armatës u krye sipas standardeve të NATO-s, si pjesë e përpjekjeve për integrim. Ajo nënkuptione racionalizimin e paisjes sipas standardeve efikase të NATO-s, e gjithashtu solli edhe deri te profesionalizimi i ARM në vitin 2004. Në periudhën në mes të vitit 2002 dhe 2007, më aktivisht u zbatuan reformat në sferën e mbrojtjes, sipas Strategjisë nationale për anëtarësim në NATO, dhe u miratuan një numër dokumentesh juridike dhe strategjike në sektorin e sigurisë, duke kyçur edhe Konceptin për siguri nationale, Doktrinën mbrojtëse dhe ndryshimet në Ligjin për mbrojtje nga

<sup>14</sup> „Galup Balkan monitor: Qasje dhe perceptime – zërat e vendeve balkanike”, viti 2008. <http://www.balkan-monitor.eu/index.php/dashboard/70-of-macedonian-albanians-supported-ohrid-agreement/>



viti 1991 dhe legjislativën tjetër. Zbatimi i reformave, edhe pse nuk ishte i butë, me gjithatë përparonte mirë dhe, deri në fund të vitit 2007, përparimi i Maqedonisë në zbatimin e reformave nga fusha e mbrojtjes, si dhe të kriteriumeve të tjera politike për anëtarësim në NATO, ishin të vlerësuara pozitivisht dhe ishte vlerësuar se Maqedonia është e përgatitur për anëtarësim në NATO. Reformat në polici u treguan si më të rënda se sa ato në Armatë, edhe përskaj kontributit të UE me misionin e saj policor (*EUPOL Proksima*) në Maqedoni. *EUPOL Proksima* kishte për detyrë të vlerësojë nevojën për reforma dhe t'i ndohmojë Qeverisë maqedonase me ekspertizën e vet gjatë zbatimit të reformave në polici, por një pjesë e madhe nga reformat e propozuara ishin politikisht të ndieshme dhe ngecën në legjislativë ose në procesin e zbatimit të tyre. Ligji për polici nga viti 2006 ishte politikisht i mohuar dhe mezi u votua nga ana e Kuvendit. Decentralizimi i policisë dhe bartja e pushtetit policor në nivel lokal ishte kontravers në gjendjen e pas konfliktit, sepse besueshmëria në polici në atë moment ripërtrihej.

Reformat në sektorin publik dhe të sigurisë ishin të kombinuara me vendosjen e decentralizimit dhe rritjen graduale të kompetencave të pushtetive lokale në shumë sfera, nga arsimi dhe urbanizmi, e deri te politika fiskale, por çka është më e rëndësishme për këtë analizë, pushteti lokal gjithashtu fitoi autorizime edhe në fushën e policisë dhe të sigurisë publike. Kjo i shënoi përpjekjet për afrimin e policisë me bashkësitë lokale, të cilat fituan të drejtën e votës për pyetje se kush është përgjegjës dhe çka duhet të bëjë policia për problemet e tyre.

Vëmendje më e vogël u ishte kushtuar reformave në pjesët tjera të sektorit të sigurisë (shërbimet e zbulimit, kompanitë private për sigurim etj.), sepse nuk ngjiteshin lartë në listën e prioriteteve të EU dhe NATO, prandaj pritej të ishin të anashkaluara dhe të prolonguara. Politika maqedonase në këtë periudhë kryesisht ishte e orientuar drejt integrimit në institucionet ndërkombëtare, kryesisht NATO dhe EU. Maqedonia u kyç në Planin aksional për anëtarësim në NATO (PAA) në vitin 1999 dhe u bë anëtare e Partneritetit për paqë në vitin 1995. Si do që të jetë, parashikimet reale për anëtarësim në NATO u paraqitën pas vitit 2002, me nënshkrimin e Kartës së Adriatikut në vitin 2003, kur ishte themeluar Treshja e Adriatikut - Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, dhe përpjekjet për plotësimin e kushteve për anëtarësim u bënë më intenzive.


## 2.1.2. Përpjekjet për reforma dhe integrim

Njëkohësisht, përpjekjet për integrim në UE u forcuan, veçanërisht pasi KE e filloj procesin e stabilizimit dhe asocimit për Ballkanin Perëndimor. Maqedonia nënshkroi Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim, me qëllim që të afrohet drejt integrimit në UE në vitin 2001, aplikoi për anëtarësim në UE në vitin 2004 dhe fitoi statusin e kandidatit kah fundi i vitit 2005. Pastaj, procesi për pranim u shty, ngase tri raportet e njëpasnjëshme për përparrim të KE nuk arritën të sjellin rekandim përfillimin e bisedimeve për hyrje.<sup>15</sup> Shtyerjet të cilat janë rezultat i përpjekjeve të pjesërisht të Qeverisë për potësimin e kërkesave të Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim (MSA) dhe i dhënies së tetë standardeve, gjithashtu e ngadalsojnë tempon e reformave dhe i zgjedhjeve përfitimet nga kushtëzimi. Nga zgjedhjet e vitit 2006 dhe ardhja e OBRM-PDUKM në pushtet, reformat e lidhura me UE u ngadalësuan dhe nuk u vërejtë ndonjë përparim në lidhje me hyrjen në UE.

Si plotësim i përpjekjeve për hyrje në UE dhe NATO, politika maqedonase, në periudhën pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ishte gjithash tu e karakterizuar me pasojat që dolën nga konflikti i vitit 2001 dhe nga sfidat e vendosura nga ana e shoqërisë së atëhershme e pas konfliktit. Nga problemet dhe kërcënime më të mëdha të politikës e pas konfliktit ishte ballafaqimi me grupet e armatosura jashta institucioneve nga të dy anët.<sup>16</sup> Njëra nga masat e para për pajtim dhe reintegrim ishte ndërmarrë nga ana e kryetarit të atëhershëm Boris Trajkovski, i cili i ndau amnesti të gjithë atyre të cilët morrën pjesë në konflikt, por nuk kryen krimë ndaj njerëzimit (në të kundërtën, do të duhej të ballafaqoheshin me gjyqet maqedonase dhe ato ndërkombëtare). Mirëpo, amnestia nuk u tregua si zgjidhje e qëndrueshme për problemin lidhur me integrimin e ish luftëtarëve dhe sasi e madhe e armëve të vogla (dhe të mëdha) lirshëm qarkullonin në mesin e veteranëve dhe kriminelëve. Ata paraqisin kërcënime për sigurinë e qytetarëve maqedonas dhe rritjen potenciale të shkallës së kriminalitetit. Veteranët e njësive paraushtarake nga konflikti iu bashkangjitën policisë, pas trajnimeve të shkurta. Kjo nuk e rriti kualitetin e shërbimeve të policisë, as besueshmëria

<sup>15</sup> Komisioni evropian. Zgjerimi. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Dokumentet kyçe. Mund t'i gjeni në: [http://ec.europa.eu/enlargement/candidate\\_countries/the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia/key\\_documents\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/candidate_countries/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/key_documents_en.htm)

<sup>16</sup> Stevo Pendarovski, „Shtojcë mbi sistemin e sigurisë nacionale“ në *Proces, viti 2002: Siguria e Republikës së Maqedonisë*. S. Pendarovski, K. Nejkov dhe I. Jusufi (Shkup: Lista, viti 2002). Fq. 11-63.



e popullatës në polici, e cila mbeti në nivel të pandryshueshmë edhe përskaj reformave rrjedhëse gjatë kohës së këtyre viteve.<sup>17</sup>

Periudha menjëherë pas konfliktit solli përpjekjen për mbledhjen e armatimit joligjor që u shfytëzua gjatë kohës së konfliktit, e cila ishte e ndihmuara nga misionet e NATO, *Korrja e domosdoshme* dhe *Dhelpra qelibare*, por asnjëra prej tyre nuk u tregua si tërësisht e suksesshme, sepse sasia e mbledhjes së armatimit ishte më e vogël se sa vlerësimi paraprak i numrit. NATO qëndroi në Maqedoni deri në vitin 2003, kur mandati i misionit *Harmonia aleata* ishte marrë nga ana e UE. Misioni i UE ishte qytetare dhe nuk kishte për qëllim të mbledhje armatim, sepse kjo pyetje ishte e zgjidhur nga ana e misioneve të NATO.

Përskaj kërcenimeve direkte të sigurisë të cilat rrjedhën nga sasia e madhe e armatimit dhe i njerëzve të përgatitur që ta përdorin ate, periudha e pas konfliktit gjithashtu solli edhe kërcenime më të buta për sigurinë -të shumtë i përkisnin rritjes së largësisë sociale në mes të grupeve etnike në Maqedoni. Natyra e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit ishte e tillë që ajo ndau të drejta në baza kolektive<sup>18</sup> të grupeve në vend të individëve, me çka zhvendosni demokracinë maqedonase edhe më larg, nga principet liberale, drejt demokracisë kolektive kosociale<sup>19</sup>. Përparësia e cila nuk mund të mohohej ishte qasja e zmadhuar ndaj fuqisë politike dhe pjesëmarrja e anëtarëve të bashkësive më të vogla etnike; në çdo rast politika maqedonase gjithnjë e më shumë etnizohej dhe numri i pyetjeve nga agjenda politike zgjidhej në kuadër të kornizave etnike dhe principi i shumicës së dyfishtë (principit

<sup>17</sup> Besueshmëria në polici në vitin 2003 arrinte 63%, sipas raportit për tërheqje të vërejtjes të UNDP, nr.1, viti 2003 <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/UNTC/UNPAN016469.pdf> dhe, me disa ngritje dhe rënje, përqindja u mbajt i nejtë deri në vitin 2008, kur gjithsej 58% nga popullata kishte besim në polici, sipas Galup Balkan monitor, viti 2008.

<sup>18</sup> Për shembull, e drejta për përdorimin e gjuhëve të tjera si oficiale, përskaj maqedonishtes, iu nda bashkësive etnike të cilët përbënë më shumë se 20% të popullsisë në një komunë të dhënë. Ndiqni Marrëveshjen Kornizë të Ohri: <http://www.siofa.gov.mk/images/dokumente/Ramkoven%20dogovor.pdf>

<sup>19</sup> Marrëveshja Kornizë e Ohrit vendosi mekanizma institucional për ndarjen e autorizimeve, si përfaqësimi proporcional, përfaqësimi i drejtë, principi i shumicës së dyfishtë gjatë votimit për pyetje me rëndësi në Kuvend dhe decentralizimi, çka i përngrjet karakteristikave të demokracisë koncensuale të përshkruara nga Arend Lijphart, *Democracy in Plural Societies: A Comparative Exploration*. (New Haven, CT: Yale University Press, viti 1977), dhe veprat e tij të mëvonshme në këtë temë.


të Badenterit) shpesh përdorej.<sup>20</sup> Kjo paraqiste kërcenim për shëndrimin e politikës maqedonase në pikë të vdekjes në mes të dy grupeve më të mëdha etnike, edhe përskaj regullit se të gjitha qeveritë maqedonase janë të përbëra nga kualicioni në mes të partisë politike maqedonase dhe asaj shqiptare. Etnizimi i politikës mund të sjellë deri te prapakthimi nationalist, sepse faktorët politik garonin për përkrahje nga ana e trupit zgjedhor dhe me te rrezikohej kërcenimi potencial i reformave demokratike dhe i politikës integrative. Nusprodhimi tjetër i konfliktit etnik ishte shfaqja e veteranëve, si faktor i ri në sektorin e sigurisë dhe në politikën në përgjithësi. Ish anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) dhe i njësive paraushtarake maqedonase iu bashkangjitën policisë dhe krijuan aleanca dhe asociacione, interesat dhe kërkosat e të cilëve ishin të kyçura në përplasjet komplekse në politikën vendore maqedonase.

Të rezonojmë, situata e përgjithshme sociopolitike në Maqedoni, në periudhën në mes të viteve 2001 dhe 2008, shfaqti karakteristika të gjendjes e pas konfliktit dhe integrative. Me fjalë të tjera, masat përmëkëmbjen nga konflikti dhe kthimin e politikës paqedashëse ishin të kombinuara me përpjekjet për bashkangjitjen e Maqedonisë drejt institucioneve ndërkombëtare UE dhe NATO, kombinim i cili pasqyrohej me aktivitetet të zmadhuara për reforma në sektorin publik dhe ate të sigurisë.

## 2.2. Analiza e institucioneve/sektorëve

Konflikti në vitin 2001, edhe pse ishte i shkurtër, i zbuloi të gjitha mangësitë dhe anët e dobëta të sektorit maqedonas të sigurisë. Si e para, u tregua se Maqedonia nuk posedon mekanizëm funksional për ballafaqimin me kriza, sepse nuk ishte e qartë se nën kompetencë të kujt është përgjigja ndaj kërcenimeve. Qendra për ballafaqimin me kriza ishte e formuar në vitin 2006, e para kësaj askush nuk ishte i obliguar për mbledhjen e informacioneve, tërheqjen me kohë të vërejtjes dhe ballafaqimin me kriza. Mangësia e integrimit të faktorëve të ndryshëm të sigurisë ishte e qartë, sepse bashkëpunimi në mes të policisë dhe Armatës, si dhe i shërbimeve të zbulimit dhe Armatës, ishte realizuar vetëm në nivelelin më të lartë ekzekutiv, gjatë kohës së mbledhjeve të Këshillit shtetëror për siguri, kurse në nivelin

<sup>20</sup> Principi i Badenterit bazohej në shumicën e dyfishtë - shumicën absolute plus shumica nga anëtarët e Kuvendit prej grupeve etnike të pakicave, për miratimin e legjislativës përsferat të cilat janë të ndieshme për marrëdhëni etnike, siç është arsimi, kultura, pushteti lokal, dokumentet personale, përdorimi i gjuhës etj.



operativ dhe ate logistik bashkëpunimi ishte i vogël. Njësitë e armatosura (Armata, policia, rezervistët, përveç njësive speciale) kishin mungesë të armatimit adekuat, paisjeve dhe shkathtësisë për pjesëmarrje në luftë dhe në luftim gueril. Edhe pse Qeveria organizonte sigurimin e shpejtë të armëve dhe paisjeve për nevojat e forcave të sigurisë, Armatën dhe policinë, u paragjith mangësi për dituri strategjike dhe përvojë, sepse shumica e viktimave nga forcat e sigurisë ishin vrapë në pritë (8 policë në Vejce, në maj të vitit 2001 dhe 10 ushtarë në Karpallak, në gusht të vitit 2001), si rezultat të mbikqyrjes dhe përkrahjes së pamjaftueshme. Për fund, shumica e policëve dhe ushtarëve me prejardhje etnike shqiptare i lëshuan forcat ushtarake që t'i bashkangjiten bashkëmendimtarëve të vet në trupat kryengritëse, me çka treguan lojalitet më të madh ndaj grupit etnik, sesa ndaj vetë shtetit. Kjo ishte tregues për problemin më të thellë shoqëror të lojalitetit të dyfishtë në mesin e anëtarëve të forcave të sigurisë, por nuk ishin të tanguar forcat maqedonase të sigurisë, sepse pas vitit 2001 në rradhët e tyre kishte shumë pak Shqiptarë etnik.

Lista e gjatë e theksuar e mangësive në sektorin maqedonas të sigurisë treguan disa drejtime në të cilat rrjedhnin reformat në sektorin e sigurisë pas konfliktit dhe si i njejtë ishte rekonstruuar. Konflikti, gjithashtu, solli edhe deri te shfaqja e aktorëve të ri të sigurisë, nga të cilët më të theksuar ishin njësitë paraushtarake nga të dy anët e prekura, UÇK dhe Luanët, si dhe veteranët e konfliktit, të cilët më vonë u bënë pjesë e skenës politike ose kryen presion mbi liderët politik.


Nga detyrat më të rëndësishme pas konfliktit ishin çarmatimi dhe demobilizimi i trupave, si dhe reformat në polici dhe ushtri, në përputhshmëri me përcaktimet e dala nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO). E para ishte e realizuar me ndihmën e NATO-s, si intitucion me kredibilitet në mesin e Shqiptarëve etnik, me qëllim që të binden sa më shumë përfaqësues të UÇK që ta dorëzojnë armatimin e tyre. Edhe përskaj këtyre përpjekjeve, misioni i NATO-s, *Korja e domosdoshme*, mblodhi më pak armatim nga ajo çka ishte e nevojshme.<sup>21</sup>, kusre ajo që nuk u arrit të grumbullohet mbeti në pronësi të paligjshme të ish ushtarëve dhe arriti deri te qarqet kriminele. Situata ishte e ngjashme edhe te njësitë paraushtarake maqedonase të cilat policia

<sup>21</sup> Forcat e Korjes së domosdoshme mblodhën 3.381 pjesë të armatimit, e cila nga ana e NATO-s u vlerësua si pothuaje dy të tretat nga arsenali i përgjithshëm i UÇK. Ndiqni deklaratën e Lord Robertson, në pres qendrën e NATO-s në Shkup, të dhënë më 25 shtator të vitit 2001. Mund ta gjeni në: <http://www.nato.int/fyrom/tfh/2001/t010925a.htm>

nuk arriti tërësisht t'i çarmatojë. Armatimi i cili u mblodh pas konfliktit u shkatërua. Demobilizimi ishte lehtësuar nga ana e kryetarit Trajkovski, i cili i ndau amnesti të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në konflikt, por nuk kanë kryer akte penale dhe krimë ndaj njerëzimit, të cilët në të kundërtën do të dorëzoheshin para gjyqit.

Si zgjidhje për integrimin e sërishtëm të ish përfaqësuesve të UÇK dhe Luanëve, të njëjtët ishin trajnuar që t'i bashkangjiten policisë. Në përputhshmëri me përcaktimet e MKO, institucionet publike duhej të fitojnë më shumë përfaqësues nga "bashkësitet jo shumicë" andaj një numër më i madh i Shqiptarëve duhej të regrutoheshin në polici. Njësia e parë e policëve shqiptarë iu bashkangjit policisë kah fundi i vitit 2001, pas trajnimit të shkurtër të siguruar nga ana e Programës ndërkombëtare për ndihmë dhe trajnim gjatë hetimeve kriminalistike (ICITAP), me qëllim që të themelohen njësitë multiethnike poliore për patrollim në rajonet të cilat ishin të kontrolluara nga UÇK gjatë kohës së konfliktit.<sup>22</sup> Më vonë, organizatat e tjera ndërkombëtare u kyçën që t'i ndihmojnë Ministrisë së punëve të brendshme gjatë trajnimi të njësive të reja poliore dhe zbatimin e reformave në polici, në fakt OSCE dhe UE, të cilët e vendosën Proksima, misionin e parë politor në Maqedoni, në vitin 2003. Këto reforma kishin për qëllim të kryejnë rregullimin e gjithanshëm të mënyrave të veprimit të policisë maqedonase, luftën efikase me kriminalitetin dhe korruptionin etj. Kryesisht, gjatë kohës së viteve pas konfliktit të vitit 2001, vëmendje të madhe të brendshme dhe të jashtme iu kushtua reformave në polici, çka solli deri te rritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike në polici. Në vitin 2003 ishte themeluar Akademia poliore, si zavendësim i Fakultetit për siguri i cili ishte mbyllur në vitin 1999, dhe e njejtë ishte dedikuar për trajnimin e policëve të rinj. Në vitin 2004, policia kuftare zëvendësoi ARM në patrollimin në kufi dhe në rripin kuftar dhe, nga vitit 2005 e këndej, ashtu siç forcoheshin mardhëniet me UE, vëreheshin përpjekjet e mëtutjeshme për udhëheqje të integruar me kufijtë, me sigurinë vendore dhe lirinë, si pjesë e procesit për lehtësimin e regjimit të vizave dhe liberalizimin e vizave në UE. Policia ishte e prekur edhe gjatë reformave në sferat tjera në Maqedoninë e pas konfliktit, si decentralizimi dhe reformat në administratën publike, andaj Ligji për polici në vitin 2006 solli principe të reja në punën e policisë, si dhe mënyra të reja për udhëheqjen me resurse njerëzore, të cilat kyçnin regrutim dhe vlerësim më transparent, kurse pushteteve lokale iu ndanë autorizime më

<sup>22</sup> Thorsten Stodiek e Wolfgang Zellner, "The Creation of Multi-Ethnic Police Services in the Western Balkans: A Record of Mixed Success," Deutsche Stiftung Friedensforschung, viti 2007.



me rëndësi në lidhje me policinë lokale dhe sigurinë, duke përfshirë edhe të drejtën për votim gjatë zgjedhjes së kryeshefit të polisës lokale.

Reformat rezultuan me marrëdhënie më të fuqishme në mes të polisës dhe faktorëve të tjerë të sigurisë në shoqëri. Policia mbeti e hapur për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe ekipet e tyre të eksperëtive, të cilët ishin përgjegjës për vlerësimin e punës dhe trajnimin e kryer. Pasi që reformat në polici u bënë prioritet i lartë në agjendën politike, ata e tërheqën vëmendjen e shoqërisë qytetare dhe bashkësisë akademike, të cilët iu bashkangjiteshin polisë më shpesh në ndjekjen për informata, ekspertizë dhe ndihmë. Me krijimin e polisës kufitare, një numër i madh i përfaqsuesve të ARM iu bashkangjitet rradhëve të polisës dhe marrëdhëni të mes të dy shtyllave kryesore të sektorit maqedonas të sigurisë ishin parashikuar të përforcohen me themelimin e Qendrës për ballafaqimin me kriza, në vitin 2006, si trup i cili më mirë do të ballafaqohet me nevojat e organeve shtetërore gjatë kohës së krizave dhe do të kontribuojë drejt sektorit më të integruar të sigurisë. Iшин bëre përpjekje për rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj polisës, veçanërisht i pakicave etnike dhe i popullatës më të gjërë, përmes themelimit të njësive poliore multietnike. Treguesit e periudhës në mes të vitit 2001 dhe 2007 nuk treguan rritje të konsiderueshme të besueshmërisë së publikut në polici, kurse sipas Raportit pë têrheqjen me kohë të vërejtjes shënohet edhe rënie e besueshmërisë gjatë kohës së këtyre viteve.<sup>23</sup> Shërbimet e zbulimit ishin më pak të prekura nga reformat rrjedhëse në polici. Pjesa e misionit *Proksima* të UE e vlerësoi punën e këtyre institucioneve dhe realizonte trajnime për përmirësimin e operativitetit dhe strategjisë së punës së tyre, mirëpo Qeveria dhe Ministria nuk i ndiqnin sugjerimet me legjislacionin e nevojshëm. Nuk ishte miratuar legjislativa e re për punën dhe statusi i shërbimeve të zbulimit, as reformat për ndjekjen e principeve demokratike për punë. Ligji për punë të brendshme nuk ishte plotësuar me përcaktimë të reja për shërbimet e zbulimit, as që ishte votuar ligji i ri për rregullimin e veprimit të tyre, prandaj shërbimet e zbulimit punonin në përputhshmëri me përcaktimet e ligjit të vitit 1995.

Gjatë kohës së kësaj periudhe rregullohej puna e agjensioneve private për siguri. Me Ligjin për sigurimin e personave dhe pronës nga viti 1999, ishte e vendosur korniza për veprimin e tyre dhe e njëjta ishte plotësuar me ndryshimet e mëvonshme në vitin 2007, kur, me qëllim që të regullohet



<sup>23</sup> Raport për têrheqjen me kohë të vërejtjes e UNDP. Viti 2004-2007. UNDP. Mund ta gjeni në: [www.ewr.org.mk](http://www.ewr.org.mk)

licencimi, kompetencat dhe trajnimi i këtyre agjensioneve, ishin themeluar trupa regulatorë (Dhoma për sigurimin e personave dhe pronës). Përskaj standardeve të përgjithshme për preventivë në punën e polisës dhe ish polisës së agjencionet private për sigurim, këto agjencione vendosën marrëdhënie më të afërta me policinë, e cila e lehtëson rrjedhën e informacioneve nga policia drejt agjensioneve private. Si plotësim, agjencionet private për sigurim ishin të lidhura edhe me partitë politike, duke i falemnderuar asaj përkatësie ata e kanë përforcuar pjesën e tyre të tregut për shërbime të sigurisë. Në këtë moment, ekzistojnë reth 30 agjacione private të regjistruara për sigurim në Maqedoni.<sup>24</sup> Rritja e tyre është tregues për përforcimin e lidhjes në mes të sektorit të sigurisë dhe sektorit privat të sigurisë, në përgjithësi, nga të cilët agjencionet private për sigurim janë vetëm një pjesë. Publiku shpeshherë është në hamendje reth të drejtave dhe obligimive të cilat i kanë këto agjencione, në përputhshmëri me ligjin e lartëpërmendor.

Periudha pas vitit 2001 gjithashtu shënoi edhe reforma të përforcuara në Armatë. Duke i falemnderuar integrimit në NATO si prioritet shtetërorë, shumë kujdes dhe resurse iu përkushtuan përmirësimit të kapacitetit të Armatës dhe përshtatshmërisë të këtij sektori ndaj standardeve ndërkombëtare në këtë sferë, kryesiht të standardeve të NATO-s. Qeveria bëri Pasqyrë strategjike mbrojtëse, në maj të vitit 2003, çka solli deri te miratimi i strategjisë së re për siguri (Koncepti nacional për siguri dhe mbrojtje), si dhe Korniza politike, vitin e njëjtë. Kjo kornizë juridike kishte për qëllim ta reformojë mbrojtjen territoriale të ushtrisë, në raport me përdorshmërinë dhe qëndrueshmërinë. Me kyçjen e Planit aksional për anëtarësim, pas Samitit të NATO-s në Washington në vitin 1999, Maqedonisë iu ishte lejuar të shërbehet me programet për ndihmë për anëtarësim në NATO dhe Qeveria filloi t'i përgatisë Programet vjetore për anëtarësim në NATO, nga viti 1999-2000 e këndej, me qëllim që t'i zbatojë reformat në sektorin e ushtrisë. Gjatë viteve që vijonin, numri i përfaqsuesve të ushtrisë u zvogëlua prej 40.000 në vitin 1999, në 3.494 në vitin 2007, dhe, deri në vitin 2006-7, ushtria ishte profesionalizuar me ndalesën për konceptin e regrutimit, kurse armatimi dhe pajisja joadekuante ishin të zëvendësuara me teknologji adekuate të NATO-s.<sup>25</sup>

<sup>24</sup> Katalogu i agjensioneve për siguri. *Dhoma e sigurimit të personave dhe pasurisë në RM*. Mund ta gjeni në: <http://www.obezbeduvanje.org.mk/KomoraContent.aspx?id=232>

<sup>25</sup> Petar Skërbina, „Rruga e gjatë drejt NATO“ në *Forum Analitika*. Vëllimi 1, (nëntor-dhjetor, viti 2006), fq.116-138.



U zbatuan programe për trajnim të sërihëm të oficerëve të cilët ishin të shpallur si tepricë teknologjike nga viti 2005 e këndej, me përkrahjen e donatorëve të jashtëm, me qëllim që të mundësohet reintegrimi më i shpejtë i personelit të mëparshëm të ushtrisë në jetën qytetare. Fotoja e Armatës ishte përmirësuar kur trupat dhe njësitë maqedonase ishin dërguar të marrin pjesë në misionet ndërkombëtare në Avganistan dhe Irak, e më vonë edhe në misionin Altea në Bosnjë, me çka ishin mbindërtuar ndëroperativiteti dhe përvaja e tyre, ishin të përforcuara marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë dhe promovohej fotoja se Armata jonë është profesionale dhe efikase.


Publiku çdo herë kishte më shumë besim në Armatë sesa në polici, andaj, në vitin 2008, rreth 70% e popullatës kishte besim në Armatë<sup>26</sup>, çka paraqet përqindje më të lartë në regjion, pas Kosovës. Pa mëdyshje, Armata është në përparësi për shkak të asaj se rrallë realizon kontakte me popullatën e thjeshtë dhe është fokusuar në misionet ndërkombëtare, prandaj nga anej ky percepçion bazohet në kontaktin më të paktë personal, se sa në ate se çka është prezantuar në mediume. Në çdo rast, mbetet fakti se Armatë është një nga institucionet në Maqedoni të cilës populli i beson më së shumti.

Qeveritë e themeluara pas vitit 2001 i përkshuan vëmendje të rëndësishme udhëzimeve të MKO, duke përfshirë edhe sektorin e sigurisë. Pjesa më e madhe e dokumenteve strategjike dhe ligjdhënëse të nevojshme për zbatimin e reformave, si dhe përparimi për anëtarësim në UE dhe NATO, ishin të miratuar pa ndonjë problem të madh nga ana e koalicionit udhëheqës në Kuvend. Si plotësim i ligjeve tanimë ekzistuese dhe dokumenteve strategjike, si Libri i bardhë i mbrojtjes dhe i Strategjisë për mbrojtje, në periudhën pas vitit 2001, Qeveria miratoi edhe Konceptuin nacional për siguri dhe mbrojtje, kurse Strategjia për mbrojtje mungonte. Përashtim i vetëm ishte Ligji për polici, i cili ishte politikisht i ndieshëm, në situatën e procesit të decentralizimit, por, duke iu falmenderuar shtypjes të cilën e imponoi UE, i njejti ishte miratuar në vitin 2006 dhe ishin zbatuar një pjesë e reformave të domosdoshme në polici.

Të rezimojmë, karakteristikat kryesore të periudhës në mes të vitit 2001 dhe 2008 janë e pas konfliktit dhe integrative. Pas konfliktit teknik të vitit 2001, Maqedonia fitoi detyrë të zbatojë një numër reformash, të cilat ishin pjesë

të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, në sistemin politik, në sektorit publik dhe në atë të sigurisë, por edhe ato që ishin të vendosura si kusht për integrim në UE dhe NATO. Me përkrahjen e jashtme të NATO dhe UE, u zbatuan reformat e mëtutjeshme në armatë e polici dhe u bënë hapat e para për rregulimin e punës së agjencioneve private për siguri. Shërbimeve të zbulimit iu përkushtua kujdes i vogël në lidhje me reformat.

<sup>26</sup> Galup Balkan monitor, viti 2008.



## PERIUDHA 3: NGA VITI 2008 E DERI MË SOT: NACIONALIZMI PAS VETOS

Rruja prej Ohrit e deri në Bukuresht është e gjatë, kurse barrën që e bartë bëhet gjithnjë e më e madhe pas ballafaqimit me portat e mbyllura të Buku-reshit. Në prill të vitit 2008, Bukureshti ishte nikoqir i Samitit të NATO-s, në të cilën pritej shtetet e Treshes së Adriatikut (Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia) të marrin ftesë për anëtarësim në Aleancë. Si do që të jetë, si rezultat i mosmarrëveshjes së pazgjidhur rreth emrit me Greqinë, e cila është anëtare e plotfuqishme e NATO-s, Maqedonia nuk fitoi ftesë për anëtarësim në NATO. Ishte vendosur anëtarësimi të shtyhet deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes rreth emrit. Vetoja e fituar në kohën e Samitit të Bukureshtit ishte ngjarje historike për politikën maqedonase, ngjarje e cila rezultonte me kufizime të shumta.

Si e para, vetoja e ndaloj Maqedoninë të bëhet anëtare e NATO-s dhe e frenoi zhvillimin e sektorit të sigurisë sipas trendeve euroatlantike në këtë sferë. Pas plotësimit të kërkesave për anëtarësim në NATO, para Samitit të Buku-reshti, Maqedonia nuk ishte më lëndë e kushtëzimit, dhe nga andej rrjedhët e dobësimi i iniciativës për vazhdimin e reformave në sektorin e sigurisë. Si e dyta, vetoja paraqiste kërcënëm për ndërrprerjen e rrjedhjes së tërësishme të reformave, mbi bazë të supozimeve se reformat do të jenë të rënda për zbatim dhe se popullata duhet t'i durojë që në të ardhmen të mbindërtohet me një standard më të mirë jetësor dhe anëtarësim të shtetit në organizatat ndërkombëtare. Vetoja në Bukuresht e tregoi pikërisht të kundërtën. Qeveritë nuk mundën më tutje të mbështeten në të njejtin argument gjatë insistimit të zbatimi të agjendës së domosdoshme për reforma. Një pjesë e elitës politike menjëherë e plotësoi këtë retorikë dhe mund të dëgjoheshin deklarata të përfaquesve dhe komentatorëve qeveritar se, pa marrë parasyshë përparimin e arritur, Maqedonia nuk do të kyçet në UE, sepse sërisht do të bllokohet nga ana e Greqisë. Nga njëra anë kjo mund të konsiderohet si e saktë, por nga ana tjetër, promovimi i dokumenteve të tilla humbëse, shërbijnë vetëm si justifikim për ngecjen e reformave dhe zgjerimin e pakënaqësisë në mes të popullatës. E treta, kërkesa e Greqisë për ndryshim të emrit kushtetues dhe vetoja në Bukuresht, për keqardhje, nuk dhanë çfarëdo kontributi drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjes rreth emrit, por pikërisht të kundërtën. Sot, 95,8 % nga popullata etnike maqedonase e ndan qën-


drimin se do të tërhiqeshin nga anëtarësimi në NATO dhe UE, po qe se kjo do të nënkupte ndryshmin e emrit të shtetit.<sup>27</sup> Qëndrimet e tilla mund të sjellin deri te zvogëlimi i përkrahjes për integrim në UE dhe NATO dhe ndryshim të politikës së Jashtme të Maqedonisë, respektivisht largimin e të njëjtës nga integrimet evroatlantike.

Sigurisht, pasoja më kërcënuese nga vetoja në Bukuresht është kthimi prapa i politikës nacionaliste në vend. Në shtetin në të cilën ka ndodhur konflikt etnik në një histori të afërt, promovimi i nacionalizmit mund të jetë shumë i rrezikshëm, sepse pakicat mund të ndjehen të përjashtuar dhe të rrezikuar nga nacionalizmi i forcuar te pjesa më e madhe e popullatës. Si plotësim, retorika nacionaliste në mes të elitave në një grup, mund të shkaktojë nacionalizëm te grupet tjera dhe me të rritet zgjerimi i nacionalizmit dhe urrejtjes. Kthimi i paradoxohshëm drejt historisë antike dhe zbulimet kuazi shkencore të sërishtë për rrënjet antike të popullit maqedonas është vetëm një hap në këtë drejtim. Retorika nacionaliste është më tërheqëse për popullin, nga ajo e bisedave për reformat, prandaj shumë reforma të nevojshme në sektorin publik ishin të lënë në prapaskenë, sepse Qeveria ishte e fokusuar në pyetjet patriotike. Retorika patriotike dhe pyetjet e lidhura me "mosmarrëveshjen për emrin" me Greqinë shpesh në prapavijë imponojnë pyetje të cilat i prekin reformat në sektorin e sigurisë. Propozimligji i paradoxohshëm për punë të brendshme, që ishte në llogari të rritjes së kompetencave të shërbimeve të zbulimit, i njekur me rritjen e mjeteve buxhetore dedikuar për shërbimet e zbulimit në fillim të vitit, shkaktoi shumë pak vëmendje nga ana e publikut dhe debatim për aplikimit të të njejtës.

### 3.1. Analiza e institucioneve/ sektorëve

Në periudhën e shkurtër pas vitit 2008 u vërejtën disa ndryshime të theksuar në organizimin e sektorit të sigurisë në Maqedoni, të cilat kishin potential të vendosin trende të reja në sektorin e sigurisë. Një ndër ngjarjet më me rëndësi të cilat e tërheqën vëmendjen e publikut ishte rritja e buxhetit të shërbimeve të sigurisë, veçanarisht të DSK, kur bëhet fjala për buxhetin e vitit 2009, që konsiderohej si vendim kontraverz nga vështrimi ekonomik, sepse buxheti ishte negociuar në mes të krizës ekonomike. Edhe përskaj krizës, për buxhetin e DZK u ndanë 25 milion evra nga buxheti i Ministrisë

<sup>27</sup> Galup Balkan monitor, viti 2008.




së punëve të brendshme, për të cilat vështirë është të thuhet se si u harxhuan, sepse publiku, madje edhe Kuvendi, kanë qasje të kufizuar në harxhimet që i bën DSK. Analiza për efikasitetin e mbykqyrjes parlamentare në punën e shërbimeve të zbulimit më tutje do të prezentohet në raportin për mbykëqyrjen parlamentare në sektorin e sigurisë. Kjo nuk paraqet rast të izoluar, sepse evideanca për dy vitet e kaluara tregon se buxheti i ushtrisë, në dy raste u shkurtua, me qëllim që të rritet buxheti i Ministrisë së punëve të brendshme.<sup>28</sup> Si plotësim të zvogëlimit të buxhetit, statusi i Armatës dhe i ushtarëve profesionist, gjithashtu, ishte kontestues. Nga fundi i vittit 2008, e deri në mesin e vittit 2009, ushtarët profesionist dolën në protestë të qetë kundër Propozim-ligjit të Armatës, me të cilin angazhimi i tyre në Armatë ishte i kufizuar në 9 vjet, së bashku me mundësitetë dhe përfitimet e tyre pas mbarimit të të njejtës. Jobaraspesa e tillë në finansimin e Armatës dhe policisë, veçanarisht të shërbimeve të zbulimit, ishte tregues për forcën që e posedonte policia në shtet, i cila nuk udhëhiqej sipas principeve demokratike të udhëheqjes.

Trend tjeter brengosës ishin kontrolli dhe mbykëqyrja e kufizuar demokratike mbi shërbimet e sigurisë. Përgjatë pothuajse pesëmbëdhjetë viteve të kaluara, puna e DSK ishte e rregulluar me Ligjin për punë të brendshme, të miratuar në vitin 1995, i cili përmban disa nene të përgjjeruara, në të cilat janë të theksuara udhëzime të përgjithshme për natyrën e punës së DSK dhe mbykëqyrjen parlamentare në të njejtën. Ligji i vendosi marginat me rëndësi për diskrecionin e drejtorit të DSK dhe Qeverisë që të vendosin për veprimin dhe strukturën e këtij trupi. Si plotësim, kontroli parlamentar, edhe pse asnjëherë nuk ishte i fuqishëm, mbeti edhe më i dobësuar, sepse në dy vitet e kaluara funksionaliteti i Komitetit parlamentar për kontrollin e punës së shërbimeve të zbulimit ishte nën nivel, për shkak se udhëheqja e zbulimit nuk i përkushtoi vëmendje të nevojshme ftesës për marrje të përgjegjësisë para publikut dhe se drejtori i DSK asnjëherë nuk u paraqit para Kuvendit. U ngritën edhe disaçështje për anëtarët e Komitetit parlamentar i cili është përgjegjës për mbykëqyrjen e punës së shërbimeve të zbulimit, sepse kryetari i komitetit, Rexhep Dauti, dhe anëtari i komitetit, Hisen Xhemiali, gjinden nën hetim për krime të luftës gjatë kohës së konf-

likitit në vitin 2001, gjatë së cilës Xhemiali i anashkalon policinë dhe gjyqet, në disa vite të kaluara.

Kryesisht, politika dhe gjendaj e sigurisë në Maqedoni, gjatë disa viteve të kaluara, nxiti pyetje për natyrën e pakthyeshme të konsolidimit demokratik dhe reformave në sektorin e sigurisë. Nganjëherë përpjekjet për integrim në NATO dhe UE krijojnë hapësirë për politikë nacionaliste dhe zvogëlimi i presionit ndërkombëtar shpiu deri te mospërfillja e reformave dhe principaleve demokratike të punës, duke bartur potencial krejtësisht ta rrezikojnë procesin e zbatimit të reformave në sektorin e sigurisë në Maqedoni.

<sup>28</sup> Natali Sotirovska dhe Igor Ilievski „Si punojnë shërbimet maqedonase të sigurisë“. Qendra për komunikim qytetar. Mund ta gjeni në: [http://www.ccc.org.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=57%3A2009-05-04-12-29-09&catid=19%3Anatali-naskovasotirovska&Itemid=21&lang=mk](http://www.ccc.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=57%3A2009-05-04-12-29-09&catid=19%3Anatali-naskovasotirovska&Itemid=21&lang=mk)



## Përfundime

Ky raport e inspektonte gjendjen e përgjithshme politike të Maqedonisë paskomuniste, me theks të veçantë të gjendjes në sektorin e sigurisë. Kryesisht, ajo i përket trendeve politike dhe zhvillimit të Maqedonisë, nga viti 1991 e këndej, me theks në aspektet nga gjendja politike të cilat janë relevante për reformat në sektorin e sigurisë. Analiza ishte e ndarë në tri periudha: i pari prej vitit 1991 e deri më vitin 2001, i dyti prej vitit 2001 e deri më vitin 2008 dhe i treti nga vitit 2008 e deri më sot. Çdo njëra nga këto periudha është e ndryshme në raport me pyetjet dominante dhe sfidat nëpër vite, si dhe natyrën dominante të gjendjes politike.

Decenia e parë nga pavarësia e shnuan themelimi i shtetit të pavarur maqedonas, si dhe reformat dhe krijimi i institucioneve të sigurisë, si Armatë dhe policia, duke përfshirë edhe shërbimet e sigurisë. Mjedisi i pasigurtë regional, në kombinim me institucionet vendore të dobëta dhe marrëdhëniet ndëretnike të prishura, krojoni mjedis jostabil të sigurisë, prej ku dalin natyra postautoritative dhe parae konfliktit të gjendjes politike.

Periudha e dyta është e pas konfliktit dhe, gjatë kohës së të njejtës, iu përkushtua vëmendje e madhe sfidave të cilat dalin nga politika e pas konfliktit dhe mjedisi i sigurisë. Ky mjedis tërroqi shumë kërkesa dhe ishte i plotësuar me përpjekjet e zmadhuara për integrim në institucionet ndërkombëtare, kryesisht në NATO dhe UE, me çka dyfish u zmadhuan përpjekjet e faktorëve vendorë politik dhe ato të sigurisë për zbatimin e reformave të nevojshme. Kjo periudhë dëshmon për kombinimin e suksesshëm të gjendjes e pas konfliktit dhe politikës integrative. Ajo e tregon natyrën komplementare të reformave të nevojshme për tejkalimin e mbeturinave nga konflikti dhe ato përfitimin e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Periudha e fundit, pas vitit 2008, drejton në rritjen e nacionalizmit dhe ndryshimin drejt politikës më të myllur në Maqedoni, pas vetos greke, gjatë kohës së Samitit të NATO-s në vitin 2008. Vetoja shkaktoi ngadalësim të reformave në sektorin e sigurisë, si dhe në shumë sfera tjera, por gjithashtu edhe ngadalësoi tempon e zbatimit të reformave të nevojshme për integrim në UE. Kjo periudhë, gjendja dominante e së cilës mund të quhet nacionaliste, dëshmon se vija në rritje sipas së cilës lëvizë tranzicioni paskomunist nuk mund të mirret si diçka e gatshme. Rasti i Maqedonisë është tregues

se anëtarësimi në NATO dhe UE nuk është çdo herë hapi që pason pas transacionit paskomunist dhe të rekonstruimit postkonfliktuoz për shenimin e fundit të tranzicionit. Kjo është e vetmi tipar i politikës maqedonase në rapport me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, që të gjitha pyetjet lidhur me reformat në sektorin politik dhe ate të sigurisë i vendos në suaza të kornizës më të hapur për zhvillim të demokracisë.

Të rezimojmë, pas shpalljes së pavarësisë, Maqedonia kaloi nëpër tri periudha të transformimit politik dhe të sigurisë. I pari, në mes të vitit 1991 dhe vitit 2001, mund të karakterizohet si kryesisht postautoritativ. Ajo cilësohej me reforma të kufizuara në sektorin e sigurisë, sepse pyetjet të cilat i përkisnin pavarësisë dhe pranimit ndërkombëtar të shtetit ishin prioritet më me rëndësi i agjendës qeveritare. Gjatë kohës së periudhës së parë, marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni u keqësuan dhe kjo shpie deri te konflikti i vitit 2001. Periudha e dytë, në mes të viteve 2001 dhe vitit 2008, e përfshin kohën në mes të konfliktit etnik në vitin 2001 dhe Samitit të NATO-s në vitin 2008, kur pritej që Maqedonia të fitojë ftesë për anëtarësim në NATO. Tiparet kryesore të kësaj periudhe janë të pas konfliktit dhe integrative, si rezultat i reformave të shumta me rëndësi të zbatuara në sektorin e sigurisë: polici, Armatë, shërbimet e sigurisë dhe Këshillin për paqë dhe siguri, me qëllim që të ndërtohet besueshmëria ndëretnike, si dhe të plotësohen kushtet për anëtarësim në NATO dhe UE. Periudha e fundit, prej vitit 2008 e këndej, e shenojnë reformat e ngadalësuara në sektorin e sigurisë dhe retorika e përforcuar nacionaliste, si rezultat i problemeve me të cilat ballafaqoheshim për fitimin e anëtarësisë në NATO dhe me bisedimet përfyrje në NATO, për shkak të mosmarrëveshjes rrëth emrit me Greqinë.

## Analiza e aktorëve kryesor politik

Uloji i aktorit	Interesat	Strategjité	Aftësi	Marrëdhënie
<b>OBRM-PDUKM, parti politike</b>				
Parti politike: demokratike, e përkrah kushtetutën.	<u>Orientimi politik:</u> konzervative, nacionaliste. Motivet: qasje në pushtet, shkatërrimi i mbeturinave nga regjimi i mëparshëm.	Mjetet politike demokratike dhe institucionale. Përdorimi i theksuar i mediumeve për kampanjë prej vitit 2006 e këndej.  Kryesisht i respektion të drejtat e njierut dhe demokracinë, me shembuj të paktë jodemokratik të udhëheqjes nga momenti i ardhjes në pushtet në vitin 2006.	Prej vitit 1990-2002, pjesë pracionaliste dhe antikomuniste e populatës. Nga vit 2006 e këndej, mësë më gjërë e humbës nga tranzicioni dhe rinia e papunësuar.  Përkrahës të ndryshëm, grup koheziv udhëheqës, nën drejtimin autoritativ të Nikola Gruevskit.  Prej vitit 2006 e këndej, lider i koalicionit në Kuvend, fuqia më e madhe për ndikim në tempone realizimit të reformave.	Aleatët kryesorë: Deri në vitin 2006, aleatët kryesor të tij janë grupe të intelektualëve dhe mediumeve antikomuniste, kurse prej vitit 2006 edhe organizatat joqeveritare, biznesi etj.  Opponentët kryesorë: LSDM dhe përkrahësit e tyre.

## ANALIZA E GJENDJES NË MAQEDONI



Raport mbi analizën e gjendjes së reformave në sektorin e sigurisë në Maqedoni (viti 1991-2008)

Parti politike: demokratike, e përkrah kushtetutën.	Orientimi politik: socialdemokrat, pasardhës të partisë së vjetër komuniste. Motivet: qasje në pushtet.	LSDM, parti politike	BDI, parti politike
	Mjetet politike demokratike dhe institucionale. Përdorimi i theksuar i mediumeve për kampanjë prej vitit 2006 e këndej.  Kryesisht i respektion të drejtat e njierut. Në vitet e hershme të nënëdhjetë, disa shembuj të udhëheqjes jodemokratike (zgjedhje problematike etj.)	Nga vitet e hershme e deri në mes të viteve të nënëdhjetë, përfshirë të fuqishme nga populli dhe institucionet tjera, duke përfshirë edhe sektorin e sigurisë. Përkrahja e popullit është në rënje.  Rjet i zhvilluar organizativ i trashëguar, miropo pas vitit 2004 bie koheziviteti i partisë.  Momentalisht opozitë me kapacitet të vogël që t'i ngadalësojë reformat.	Aleatët kryesorë në vitet e nënëdhjetë janë aleatët e brendshëm që vijojnë: siguria, biznesi, elita e re e biznesit, mediumet, faktori ndërkombëtar.  Kohët e fundit: rënje e përkrahjes në bashkësinë e sigurisë dhetë biznesit, si dhe të mediumeve.  Opponentët kryesorë: OBRM-PDUKM dhe intelektualët antikomunist.
	<u>Orientimi politik:</u> e qendrës së djathë, trashigimtare e UÇK. Motivet: qasje deri në pushtet, ritjen e të drejtave kolektive të populatës etnike shqiptare.	Kryesisht me mijte politike demokratike, kohë pas kohe i bashkangjitur opozitës jaشتë institucioneve dhe kërcënohet me dhunë.  I përkrah të drejtat e njërzëve dhe demokracinë, në momente është e përzier në dhunë dhe mashtime gjatë kohës së zgjedhjeve.	Pas vitit 2001, pjesa më e madhe e populatës etnike shqiptare, duke i përfshirë intelektualët dhe mediumet.  Organizatët kohezive, më pak përkrahës koheziv.  Partia më e madhe etnike shqiptare, përmes MKO dhe me principin e shumicës së dyfishët ka fuqi të madhe të ndikojënë rrijehën e reformave.

PDSH, parti politike	
Parti politike: demokratike, ngadonjëherë nuk e përkrah kushtetutën.	Kryesisht me mijete politike demokratike, kohë pas kohe i bashkangjitet opozitës jashtë institucioneve.  I përkrah të drejtat e njerezve dhe demokracinë, në momente është e përzier në dhunë dhe mashtime gjatë kohës së zgjedhjeve.  Motivet qasje deri në pushimet, rritjen e të drejtave kolektive të populatës etnike shqiptare.
Aktor i cili e përkrah regjimin.	Orientimi politik: gjatë kohës së viteve të nëntëdhjetë, ky medium shtetëror e përkrahte Qeverinë dhe ideologjinë e saj – socijaldemokrate, e cila lindi në traditë të përkrahjes së partive politike në pushtet.  Motivet qasje deri te mijetët nga buxheti shtetëror.

RTVM, medium shtetëror			
Orientimi politik: gjatë kohës së viteve të nëntëdhjetë, ky medium shtetëror e përkrahte Qeverinë dhe ideologjinë e saj – socijaldemokrate, e cila lindi në traditë të përkrahjes së partive politike në pushtet.	Nga mesi i viteve të nëntëdhjetë, përfjeton përkrahye të madhe nga populata etnike shqiptare, e cila bie nga viti 2002 e këndej Kohenziviteti i partisë bie, si dhe përkrahja nga populli. Në vitin 2008, frakzioni i lëshoi partinë dhe formoi partit të re (DR), e cila ia zogëloj përkrahjen populllore dhe politike çka fitonte PDSH. Deri para do kohë, ishte partia e dytë etnike shqiptare dhe kishte fuqi të ndikojë në reformat.		
Kryesisht demokratike	Informimi i publikut dhe bartja të porosisë që partitë në pushtet dëshironjë ta përcjelin. Sugjerim i kufizuar demokratik, si rezultat i lidhjes së fuqishme në mes të elitarës udhëheqëse dhe përkushtimit diskutabil ndaj pavarësisë së mediumeve. Motivet qasje deri te mijetët nga buxheti shtetëror.	Në vitet e hershme të nëntëdhjetë, RTVM ishte burimi i vetëm i informacioneve në më shumë pjesë të shtetit, por në rritjen e numrit të mediumeve private e humb përkrahyen.. Pjesa e madhe e personelit të tij e braktisi, por ai i cili imbeti është kryesisht koheziu me partitë politike udhëheqëse. Kapacitet i kufizuar që të ndikojë, sepse i ndjek vendimet oficiale qeveritare.	Në vitet kryesorë: Qeveria, partitë politike në pushtet. Oponentët kryesorë: nuk ka oponent por konkurençë të cilën e përbëjnë mediumet private.

Medium private				
Kryesisht demokratike	Orientimi politik: i ndryshëm, proqeveritar, kurse disa janë antiqeveritar, në varshamëri nga bashkëpronësia.  Motivet: përfitimi ekonomik, plasman i tregun medial, besueshmëria në populull.	Gazetari hulumtuese, propagandë të treguarit e ajendës, promovim i qëndrimeve.  Kryesisht, dosjes solide e raportimit përtë drejtat e njerezve, vëcanarish në dekadën e kaluar dhe, me më pak përfashitme, qëndrim prodemokratik dhe informim.	Në vitet e mesme dhe të vona të nëntëdhjetë, rritet përkraha që e fiton nga populli.  Si grup, mediumet private nuk janë koheziu dhe shpeh kacftën në sulmet e ndërsjellta. Gazeta e mbrojnë interesin e përbashkët me kyqjen e tyre. Kapacitet të kufizuar përtë ndikuar në reformat, përmes ndikimit ndaj perceptimit publik të politikës dhe agjendës së vendosur.	Në vitet kryesorë: bashkëpronësia; partive politike, ndërrmarje private. Oponentët kryesorë: shëpitë konkurrente mediale.
Përkushtim i kufizuar ndaj demokracisë.	Orientimi politik: nacionalist, djathtist..  Motivet: mbrojtja e të drejtave dhe privilegjeve të anëtarëve të tyre.	Metodat e të vepruarit: shqërimi, anëtarësimi në parti politike.  Respektimi i të drejtave të qytetarëve: mjaft të kufizuar, sepse veteranët e konfliktit janë të akuzuar os janë nën hetim për shkelje të të drejtave të qytetarëve gjatë konfliktit.  Rekomandimi demokratik: i kufizuar, nga anash nga përkraha populllore gjatë konfliktit.	Baza e përkrahjes; në mesin e pjesës nacionaliste të popullit, vëcanarish shokët dhe familjet e viktimate nga konflikti.  Kohozino i gruptit Jokohezive. Veteranët maqedonas u ndanë në atë cilët iu bashkangjitur forcave të sigurisë dhe të atyre të cilët nuk e bënë këtë. E njëta vlen edhe për veteranët shqiptar, me plotësim të ndarjes për shkak të partive politike.  Ndikim i pjesërishtëm në tempone reformave në sektorin e sigurisë, për shkak të posedimit të armëve dhe të rrijeteve ekzistuese në mes të anëtarëve.	Aleatët kryesorë: disa aktorë politik - përveteranët maqedonas Lube Boshkovski, përveteranët shqiptar kryesisht BDI.  Oponentët kryesorë: ekziston rivaliteti në mes të përfaqësuesve të forcave të regulitës së sigurisë dhe veteranëve nga konflikti.





## ANALIZA E GJENDJES NË MAQEDONI

Raport mbi analizën e gjendjes së reformave në sektorin e sigurisë në Maqedoni (viti 1991–2008)

Bashkësia e biznesit		Organizatat ndërkombëtare	
Aktorët e regjimit, por jo së tepërm demokratike.	Orientimi politik: në varshmëri nga partia në pushimet Kryesishët, gjatë kohës së viteve të nentëdhjetë, shumica prej tyre e përkrah LSDM, e cila administronte me privatizimin. Kohëve të fundit, përkrahjen e vet e orienton drejt Qeverisë së OBRM-PDUKM. Motivet: para se gjithash përfitimi ekonomik; ndikimi politik si mijet për përfitime më të madha ekonomike.	Nuk fiton përkrahje të madhe nga populli, por disponon më mijetë të mëdha finanziare dë fiton përkrahje të fuqishme nga politikanët. Nuk është kohezive në pamjen politike, por shërbeshet me politikën me qëllim që t'i dëmtojë konkurençës. E bafasueshme është ndikimi i saj në reformat në sektorin e sigurisë. Njëri nga ministrat për punë të brendshme dhe drejtori i DSK vijnë pikërisht nga bashkësia e biznesit.	Aleatët kryesorë: politikan dñe parti politike. Oponentët kryesorë: nuk ka oponentë më të madhenj.
Prodemokratike.	Orientimi politik: kryesishët nuk janë politikisht të përcaktuar, por disa donatorë dhe fondacione preferonë të punojnë me aktorët politik nga një pjesë e spektrit politik. Motivet: stabilizimi dhe siguria e regionit dhe Maqedonisë; konsolidimi demokratik.	Mетодат е веprimit политик: пресия дне култите, индустрији (техники, ме експертize, финансии), пërkrahje për një pjesë të populatës dne организative,joqeveritare. Të drejtat e njeriut dñe rekomandimet demokratike: mjaff të përkushtuar ndaj itë drejtave të njeriut, disa prej tyre kanë edhe kompetencë gjyqësore për këtë sférë (GJNPJ) dne ofrojnë përkrahje për promovimin e demokracisë.	Aleatët kryesorë: sektori qytetar, partitë politike (disa më pak se të tjera). Oponentët kryesorë: pa opONENTë me rendësi, grupe marginale të cilët kundërshtojnë anëtarësimin në NATO dñe UE.

## KRONOLOGJIA





## KRONOLOGJIA SË REFORMAVE NË SEKTORIN E SIGURISË 1991 – 2009

### Shenimi hyrës për kronologjinë


Ky dokument është prodhim i Projektit “Hartimi dhe monitorimi i reformave në sektorin e sigurisë në Ballkanin Perendimor” dhe e përban kronologjinë e ngjarjeve më kryesore të lidhura me reformat në sistemin e sigurisë (RSS) në Maqedoni, nga viti 1991 e deri më 2009. Janë të kyçura edhe ngjarjet të cilat e shnuan gjendjen e RSS në Maqedoni.

#### Viti 1991

- Kiro Gligorov u zgjodh për kryetar të Maqedonisë së pavarur nga ana e Parlamentit. Kjo mënyrë e zgjedhjes ishte e realizuar në përputhshmëri me rregullat ekzistuese nga regjimi paraprak.
- Maqedonia e mbajti referendumin e saj për pavarësi, më 8 shtator. Qytetarët kishin mundësi të deklarohen se a dëshirojnë që Maqedonia të jetë shtet i pavarur dhe i mëvetësuar ose të jetë pjesë e federatës së re me republikat tjera jugosllave.<sup>29</sup> Në bazë te rezultatit nga ky referendum, Kuvendi e miratoi Dekleratën për pranimin ndërkombëtar të Republikës së Maqedonisë, duke u thirrur në pranimin ndërkombëtar.<sup>30</sup>
- Qeveria e parë e Republikës së pavarur të Maqedonisë ishte e udhëhequr nga Nikolla Klusev. Kjo qeveri e përkohshme e cila ishte e formuar që të udhëheq për periudhën para krijimit të Kuvendit të

<sup>29</sup> Struktura politike. *Republika e Maqedonisë, Ministria e punës të jashtme.* <<http://www.mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=289>>. E shpallur më 25 tetor të vitit 2008.

<sup>30</sup> Historia. *Republika e Maqedonisë, Ministria për punë të jashtme.* <<http://www.mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=289>>. E shpallur më 25 tetor të vitit 2008.



ri (e formuar pas zgjedhjeve të mbajtura në nëtor të vitit 2009), e formonte Qeverinë e re pasfederative. Si edhe të jetë, partia fituese OBRM-PDUKM (VMRO-DPMNE) nuk fitoi përkrahje të mjafueshme nga ana e Kuvendit që të formojë qeverinë, sepse refuzoi të futet në koalicion me partitë tjera.

- Kushtetuta e Re e Republikës së Maqedonisë ishte miratuar nga ana e Kuvendit, më 17 nëntor.<sup>31</sup> Ajo ishte kushtetuta e parë e Maqedonisë së pavarur, që dhe edhe më tej është në fuqi.

## Viti 1992

- Në janar të vitit 1992, komisioni i Badenterit për arbitrazhë e vlerësoi Kushtetutën e Maqedonisë si demokratike dhe vlerësoi se e njejtë i plotëson kushtet e nevojshme për pranim ndërkombëtar.<sup>32</sup>
- Kryetari Kiro Gligorov dhe përfaqësuesit e Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ) nënshkruan marrëveshje sipas së cilës APJ duhej të tërhiqej na Maqedonia deri më 15 prill. Pas tërheqjes së APJ ishte krijuar Armata e Republikës së Maqedonisë.
- Garda nationale maqedonase ishte e krijuar nga ana e OBRM-PDUKM (e cila atëherë ishte në opozitë), gjëja me qëllim që të mbrojë Maqedoninë në rast të përlleshjes me APJ.<sup>33</sup>
- Referendumi (i cili konsiderohej si i pavlefshëm sepse nuk u krysipas procedurës ligjore për realizimin e referendumit) ishte mbajtur nga ana e Shqiptarëve për ndarje nga Maqedonia, dhe i njejtë ishte i përcjellur me shpalljen e "Republikës së Iliridës".

<sup>31</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. <<http://www.slvesnik.com.mk/WBStorage/Files/USTAV-eng.pdf>>. E shpallur më 25 tetor të vitit 2008.

<sup>32</sup> Mendimi 5. *Dokument zyrtar nga Komisioni i Badenterit*. <[http://www.google.com/url?sa=t&source=web&ct=res&cd=4&url=http%3A%2F%2Fwww.la.wayne.edu%2Fpolisci%2Fdubrovnik%2Freadings%2Fbadinter.pdf&ei=oqVHSYLYLp3SQNjrIRA&usg=AFQjCNHRLUAYW-4iql9ShFPAUt-hfs-mNg&sig2=AA38COt4St4nre1Y\\_bFvhg](http://www.google.com/url?sa=t&source=web&ct=res&cd=4&url=http%3A%2F%2Fwww.la.wayne.edu%2Fpolisci%2Fdubrovnik%2Freadings%2Fbadinter.pdf&ei=oqVHSYLYLp3SQNjrIRA&usg=AFQjCNHRLUAYW-4iql9ShFPAUt-hfs-mNg&sig2=AA38COt4St4nre1Y_bFvhg)>.

<sup>33</sup> Vankovska, Biljana. *Reformat në sistemin e sigurisë në Republikën e Maqedonisë*. Në Traçans, Jan dhe Phillip H. Fluri (red.). *Defence and Security Sector Governance and Reform in South East Europe: Insights and Perspectives, Volume II - Macedonia, Moldova, Romania*. Geneva, Belgrade: DCAF, CCMR, 2003: 28.

- Misioni vëzhgues për vërshim të konflikteve e OSBE në Shkup, e cila është misioni më i gjatë deri më tanë, ishte i vendosur në Shkup. Gjatë kohës së veprimit shumëvjeçar të saj në Maqedoni, ajo ishte iniciator, sigurues i mjeteve finansiare dhe i ekspertizës së shumë projekteve për RSS në Maqedoni.<sup>34</sup>
- Ligji i parë kushtetues i Republikës së Maqedonisë, Ligji për mbrojtje, ishte i votuar në Kuvend, në shkurt. Ky ligj krijoi shumë paqartësi në lidhje me të drejtat, obligimet dhe kompetencat e sektorit mbrojtës. Nga andej, ai duhej të ndërrohet me ligj të ri në vitin 2001.
- KB (të ftuara nga kryetari i Maqedonisë, Kiro Gligorov, si dhe nga përpjekjet diplomatike të bashkëkryesuesve me Konferencën ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, Sajrus Vens dhe Lord Owen) vendosën misionin e saj UNPROFOR në Maqedoni. UNPROFOR kishte përdetyrë ta parandalojë derdhjen e konfliktit në Maqedoni.<sup>35</sup> Ai patrolonte nëpër kufijtë e rinj të Maqedonisë, së bashku me përfaqësuesit e Mbrojtjes territoriale, deri atëherë kur Armata e Republikës së Maqedonisë nuk ndërtói kapacitete për ballafaqim me këtë detyrë.

## Viti 1993


- Rezulata 817 ishte miratuar nga ana e Këshillit të sigurimit e KB, me sugjerim për Asamblenë Gjenerale të KB se Maqedonia është e pranuar si anëtare e KB, nën referencën e përkohshme (Ish Republika Jugoslave e Maqedonisë), më 7 prill<sup>36</sup> dhe se është sjellur vendim për anëtarësimin e saj në Asamblenë gjenerale më 8 prill.<sup>37</sup>

<sup>34</sup> Misioni vëzhgues për shtrirjen e konflikteve të OBSE në Shkup. OBSE. <<http://www.osce.org/skopje/>>. E shpallur më 15 dhjetor të vitit 2008.

<sup>35</sup> UNPROFOR. *Faqja e internetit e KB*. <[http://www.un.org/Depts/dpko/dpko/co\\_mission/unprof\\_b.htm](http://www.un.org/Depts/dpko/dpko/co_mission/unprof_b.htm)>. Shpallur më 3 dhjetor të vitit 2008.

<sup>36</sup> Rezulata 817. UNHCR. <<http://www.unhcr.org/refworld/category,LEGAL,,MKD,3b00f15623,0.html>>.

<sup>37</sup> Pranimi i shtetit aplikimi i të cilit është i përfshirë në dokumentin A/47/876-S/25147 për anëtarësim në Kombet e bashkuara. *Kombet e bashkuara*. <<http://www.un.org/documents/ga/res/47/a47r225.htm>>. E shpallur më 25 tetor të vitit 2008.



- Rezulata me të cilën tregohet gadishmëria e Maqedonisë për kyçje në NATO ishte e miratuar nga ana e Kuvendorit maqedonas, në dhjetor të vitit 1993.<sup>38</sup>

## Viti 1994

- U mbajtën zgjedhjet e dyta parlamentare. Lidhja socijaldemokrate majtiste e qendrës (LSDM) u pajis edhe me një mandat përgjatë kohës së këtyre zgjedhjeve dhe Branko Cërvenkovski formoi qeveri me partnerin shqiptar të koalicionit, PPD, kombinim politik i cili e udhëhoqi shtetin deri më vitin 1998.
- Zgjedhjet e dyta presedenciale u mbajtën njëkohësisht me zgjedhjet parlamentare. Kryetari i atëhershëm, Kiro Gligorov, morri edhe mandatin e dyte dhe ishte në funksion deri më vitin 1999.

## Viti 1995

- Ishte miratuar Ligji për punë të brendshme për rregullimin e punës të Ministrisë së punëve të brendshme. Ligji, nga viti 1995, përfshinte mbikqyrjen e Kuvendorit në punën e shërbimeve të zbulimit. Komisioni parlamentar e mbikqyrte punën e shërbimeve të fshehta (Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim) dhe i paraqiste raport vjetor Kuvendorit. Puna e polisë ishte gjithashtu e rregulluar me ndihmën e këtij ligji, deri më vitin 2007, kur Ligji për polici hyri në fuqi.
- U miratua Ligji për Agjensionin për zbulim. Agjensioni ishte vendosur si trup i veçantë, nën mbikqyrje direkte të kryetarit të Kuvendorit, me çka u ndanë shërbimet e zbulimit dhe kundërzbulimit, të cilat deri atëherë ishin nën kompetencë të Shërbimit shtetëror të sigurisë. Drejtorin e Agjensionit për zbulim e emëronte presidenti, e jo Qeveria (Ministri për punë të brendshme) dhe i nejti paraqet raport për punën e tij direkt te presidenti. Si do që të jetë, Agjensioni filloj me punë në vitin 1997, me zgjedhjen e shefit të saj.

<sup>38</sup> Kronologjia e Maqedonisë dhe NATO-s. *Ministria e punëve të jashtme*. <http://www.mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=313>. E shpallur më 25 tetor të vitit 2008.

- Gjatë kohës së hapjes së Universitetit të atëhershëm jo të ligjshëm të Tetovës (më voni i pranuar si Universiteti Shtetëror i Tetovës), policia intervenoi dhe me dhunë e shpërndau masën e tubuar të njerëzve. Në atë periudhë, nuk ekzistonte mësim në gjuhën shqipe në arsimin e lartë në Maqedoni. Incidenti paraqiste pjesë nga xixat dhe forcat lëvizëse për trazirat në pjesët perëndimore të Maqedonisë.
- Më 13 shtator, me Greqinë u nënshkrua marrëveshja e përkohshme lidhur me mosmarrëveshjen rrëth emrin, me të cilën Maqedonisë iu nda e drejta për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare (duke përfshirë edhe KB), me emrin e përkohshëm Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM), dhe që të dy anët, ajo maqedonase dhe ajo greke, ishin të ftuara të gjejnë zgjidhje të përbashkët lidhur për mosmarrëveshjen rrëth emrit.
- Misioni UNPROFOR ishte i ndërruar me misionin UNPREDEP. Kjo ishte misioni i parë preventiv në historinë e KB.<sup>39</sup>
- Maqedonia u bë anëtare e Partneritetit për paqë. Në nëntor të vitit 1995 ishte nënshkruar marrëveshja kornizë në mes të Maqedonisë dhe NATO për hyrje në Partneritetin për paqë (PPP).<sup>40</sup>
- Në tetor ndodhi përpjekje për vrasjen e presidentit Gligorov, me vendosjen e bombës në automobilin e tij. Kryerësit e këtij akti ende janë të panjohur.
- Ishte themeluar Akademia ushtarake.



## Viti 1996

- Ishte nënshkruar Marrëveshja për statusin e forcave (SOFA) në mes të NATO-s dhe Maqedonisë, me çka forcat e NATO-s fituan autorizim t'i kryejnë aktivitetet e veta në territorin e Maqedonisë.<sup>41</sup>

<sup>39</sup> UNPREDEP. Faqja e internetit e KB. <<http://www.un.org/Depts/DPKO/Missions/unpredep.htm>>. E shpallur më 3 dhjetor të vitit 2008.

<sup>40</sup> Kronologjia e Maqedonisë dhe NATO-s. *Ministria për punë të jashtme*. <http://www.mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=313>. E shpallur më 25 tetor të vitit 2008.

<sup>41</sup> Kronologjia e Maqedonisë dhe NATO-s. *Ministria për punë të jashtme*. <http://www.mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=313>. E shpallur më 25 tetor të vitit 2008.



- Në korrik, Maqedonia e hapi zyren e vet për lidhje me shtabet e NATO-s në Brisel.

## Viti 1997

Agjensioni për zbulim, i cili ishte i themeluar me Ligjin e vtit 1995, më në fund filloj të punojë efektivisht, sepse ishte emëruar drejtori i parë i saj.<sup>42</sup>

- Në korrik, policia u ndesh me civilët në Gostivar dhe Tetovë, me qëllim që t'i menjanojë flamujt e vendosur shqiptar dhe turk para komunave të qyteteve; vendosja e flamujve ishte shpallur si diçka e kundërt me Kushtetutën nga ana e Gjyqit kushtetues. Një person vdiq, kurse disa ishin të plagosur, për çka prefekti i Gostivarit, Ruli Osmani, u soll në gjykatë dhe iu shqiptua denim me burg. Kjo ngjarje shkaktoi keqësim të marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni.
- Në poligonin ushtarak afër Negotinës u mbajt ushtrimi i parë ndërkombëtar ushtarak në Maqedoni – *Shpëtimtari '97*.

## Viti 1998

- U mbajtën zgjedhjet e treta parlamentare, gjatë së cilës kësaj here nuk fituan të nejtar parti. OBRM-PDUKM fitoi në zgjedhje, së bashku me partinë opozitare PDSH, si partner i saj i koalicionit. E dyta ishte LSDM, e cila për herë të parë mbeti opozitë.<sup>43</sup>
- Në territorin e Maqedonisë u mbajtën ushtrime në të cilat morrën pjesë forcat ajrore dhe ushtria e NATO-s dhe PPP. Njësitë speciale maqedonase ishin të kyçura në ushtrime.
- Në gusht u miratua Libri i bardhë i mbrojtjes

<sup>42</sup> Vankovska, Biljana. Reformat në sistemin e sigurisë në Republikën e Maqedonisë. Në Trajans, Jan and Phillip H. Fluri (red.). Defence and Security Sector Governance and Reform in South East Europe: Insights and Perspectives, Volume II - Macedonia, Moldova, Romania. Geneva, Belgrade: DCAF, CCMR, 2003: 27.

<sup>43</sup> Zgjedhjet, viti 1998. *Faqja e internetit për zgjedhjet*. <<http://www.izbori.gov.mk/parlamenti%2098/index.html>>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

## Viti 1999

- Si rezultat i vetos të Kinës, në shkurt, mandati i UNPREDEP-it u ndërrpre.<sup>44</sup>
- Rreth 40.000 trupa të NATO-s ishin të pozicionuar në territorin e Maqedonisë, gjatë kohës së krizës në Kosovë, në vitin 1999 (numër i cili është katër herë më i madh nga numri i përfaqësuesve të ARM).
- Maqedonia zyrtarisht u bë kandidate për anëtarësim në NATO.<sup>45</sup>
- U mbajtën zgjedhjet e treta presidenciale. Boris Trajkovski, i cili ishte nominuar nga ana e partisë që atëherë udhëheqte, OBRM-PDUKM, fitoi në zgjedhjet dhe u bë presidenti i Maqedonisë për pesë vitet e ardhshme.<sup>46</sup>
- Në shtator u miratua Strategja për mbrojtje.

## Viti 2000



- Maqedonia, së bashku me Shqipërinë, Bullgarinë, Romaninë, Slloveninë, Sllovakinë, Latvinë, Estoninë dhe Litvaninë (e më vonë edhe Kroacinë), e krijoj Vilnius grupin.<sup>47</sup>
- Në mes të 10.000-15.000 dosieve policore, të cilat datojnë nga vitet e hershme të komunizmit, u vunë në dispozicion të publikut. Kjo ishte përpjekja e parë për shtrimin e të dhënave për të kaluarën komuniste dhe hap përpara drejt lamtumirës me epokën e RSFJ.
- U miratua plani aksional për mbrojtje shtetërore.

<sup>44</sup> UNPREDEP. *Faqja e internetit e KB*. <<http://www.un.org/Depts/DPKO/Missions/unpredep.htm>>. E shpallur më 3 dhjetor të vitit 2008.

<sup>45</sup> Kronologjia e Maqedonisë dhe NATO-s. *Ministria për punë të jashtme*. <http://www.mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=313>. E shpallur më 25 tetor të vitit 2008.

<sup>46</sup> Zgjedhjet, viti 1998. *Faqja e internetit për zgjedhjet*. <<http://www.izbori.gov.mk/parlamenti%2098/index.html>>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>47</sup> Kronologjia e Maqedonisë dhe NATO-s. *Ministria për punë të jashtme*. <http://www.mfa.gov.mk/default1.aspx?ItemID=313>. E shpallur më 25 tetor të vitit 2008.



## Viti 2001

- Afera për përgjimin telefonik u zbulua nga ana e Branko Cërvenkovskit (atëherë lider i opozitës), në janar.<sup>48</sup> Ajo nxiti debate për regulimin e kontrollimit të komunikimit nga ana e shtetit, por ligj përkëtë nuk u miratua deri më vitin 2006.
- Ekipi raportues televiziv mbahej peng në fshatin e Shkupit, në Tashnushë, në shkurt, në momentin kur ai përpinqej ta viziton fshatin, me qëllim që t'i verifikojë spekulimet se grupet e armatosura patrolojnë nëpër fshat. Snezhana Lupevska ishte e para e cila ofroi njohtimin për atëherë konfliktin e ardhshëm. Ai ishte fillimi i konfliktit i cili zgjati deri në gusht.
- Më 9 prill në Brisel u nënshkrua Marrëveshja për stabilizim dhe asocim. Maqedonia ishte shteti i parë i cili ndonjëherë nënshkroi kësi lloj marrëveshje. Marrëveshja për stabilizim dhe asocim sot është vegël e njohur e cila zbatohet në Ballkanin Perëndimor.<sup>49</sup>
- Për shkak të situatës në Maqedoni, opozita bëri ftesë për krijimin e qeverisë së shpëtimit kombëtar. Kjo kërkesë kishte mbështjen e bashkësisë ndërkombëtare, prandaj qeveria e tillë u formua më 13 maj.
- Gjatë kohës së konfliktit, Ministri i punëve të brendshme, Lube Boshkovski, e themeloi njësinë speciale policore *Luanët*, në të cilën u regrutuan volonterë dhe policë rezervistë të cilët luftuan gjatë kohës së konfliktit.
- Më 13 gusht u nënshkrua Marrëveshja Kornizë e Ohrit, me të cilën formalisht mbaroi konflikti në Maqedoni, në vitin 2001. Kjo marrëveshje ishte nënshkruar nga ana e liderëve të katër partive më të mëdha politike – Lubço Geogrevski (OBRM-PDUKM), Branko Cërvenkovski (LSDM), Imer Imeri (PPD) dhe Arben Xhaferi (PDSH), kryetari i shtetit dhe përfaqësues të UE dhe SHBA.
- I pari nga seria e misioneve të NATO-s filloi në gusht. Ai ishte misioni *Korja e domosdoshme*, i cila kishte për qëllim ta mbledh armatimin

<sup>48</sup> Bisedat e përgjuara telefonike të Cërvenkovskit dhe Xhaferit. A1 televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=2215>>. E shpallur më 15 dhjetor të vitit 2008.

<sup>49</sup> Komisioni evropian. Zgjerimi i Unionit evropian. <[http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia/eu\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia\\_relations\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/eu_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_relations_en.htm)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

nga luftëtarët e UÇK.<sup>50</sup> Misioni *Dhelpra qelibare*, i cili filloi në shtator të vitit 2001, e zëvendësoi misionin *Korja e domosdoshme*.<sup>51</sup>

- Ndryshimet kushtetuese të parashikuara në MKO ishin miratuar. Ata paraqisin bazë për të gjitha ligjet në bazë të të cilave zbatohej.<sup>52</sup> Në mes tjerash, ishte parashikuar përfaqësimi i drejtë i të gjitha grupeve etnike në polici dhe Armatë.

## Viti 2002

- Një ndër misionet e fundit të NATO-s, *Harmonia aleata*, u mbajt prej dhjetorit 2002 e deri në mars të vitit 2003.<sup>53</sup> Ajo u zëvendësua me Konkordia, misioni i parë i UE në përgjithësi.
- Konkordia, misioni i UE, filloi në mars të vitit 2003. Ai zgjati deri në dhjetor të vitit 2003.<sup>54</sup>
- Në mars të vitit 2002 u mbajt konferanca e donatorëve për Maqedoni, gjatë së cilës kohë Maqedonia fitoi 307 milion euro nga donatorët.<sup>55</sup> Si edhe të jetë, këto fonde ishin të kushtëzuara dhe paraqisin një lloj kredie.
- U miratua Ligji për amnosti. Me kët ligj iu nda amnosti të gjithë atyre të cilët kryen veprat penale, gjatë kohës së periudhës më mes të 1 janarit të vitit 2001 dhe 26 shtatorit të vitit 2001.<sup>56</sup>

<sup>50</sup> Botim i NATO-s: Operacioni *Korja e domosdoshme*. Faqja e internetit e NATO-s. <<http://www.nato.int/fyrom/tfh/home.htm>>. E shpallur më 13 nëntor të vitit 2008.

<sup>51</sup> Botim i NATO-s: Operacioni *Dhelpra qelibare*. Faqja e internetit e NATO-s. <<http://www.nato.int/fyrom/tff/home.htm>>. E shpallur më 13 nëntor të vitit 2008.



<sup>52</sup> Ndryshimet kushtetuese. *E drejta*. <<http://www.pravo.org.mk/download.asp?ID=2&slID=326>>. E shpallur më 6 nëntor të vitit 2008.

<sup>53</sup> *Harmonia aleata*. Shtabet e NATO-s. <<http://www.nhq.nato.int/missions/alliedHarmony/alliedHarmony%20Mission.htm>>. E shpallur më 13 nëntor të vitit 2008.

<sup>54</sup> Konkordija. Këshilli i Unionit Evropian. <[http://www.consilium.europa.eu/cms3\\_fo/showPage.asp?id=594&lang=EN](http://www.consilium.europa.eu/cms3_fo/showPage.asp?id=594&lang=EN)>. E shpallur më 13 nëntor vitit 2008.

<sup>55</sup> Maqedonia fitoi 307 milion evra nga konferanca donatore. A1 Televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=6818>>. E shpallur më 25 dhjetor të vitit 2008.

<sup>56</sup> Ligji për amnosti. *E drejta*. <<http://www.pravo.org.mk/download.asp?ID=1&zID=22>>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.



- U mbajtën zgjedhje të reja parlamentare. LSDM fitoi mandatin për të udhëhequr deri në vitin 2006. Branko Cërvenkovski fitoi mandat të krijojë qeveri.<sup>57</sup>
- Njësia policore Luanët ishte shpërndarë në nëntor.
- Pasqyra strategjike e mbrojtjes (Korniza politike) u miratua në tetor, kurse Koncepcioni nacional për siguri dhe mbrojtje u miratua në qershor.
- Plani dinamik për transformim të ARM u miratua nga ana e Kuventit në maj.

## Viti 2003

- Kryerësit e panjohur hodhën granatë mbi objektin e Qeverisë në Shkup. Qevria pohonte se bëhet fjalë për sulm terroristik.<sup>58</sup>
- Më 1 nëntor filloj aksioni për çarmatimin vullnetarë dhe e njëjtë ishte paraparë të zgjasë dy javë, gjegjësisht deri më 15 dhjetor.<sup>59</sup>
- Konkordia, misioni paqësor i UE, mbaroi më 15 dhjetor dhe ishte i zëvendësuar me Proksima, misionin policor të UE.<sup>60</sup> Rol i Proksima më vonë u morr nga ana e EUPAT, tim më i vogël këshillënës policor i UE.<sup>61</sup>
- Ministria e punëve të brendshme e shpërndau njësinë speciale policore Luanët, e cila ishte e formuar gjatë kohës së konfliktit në vitin 2001. Gjysma e përfaqësuesme të saj u bë pjesë e forcave të rregullta policore.

<sup>57</sup> Zgjedhjet, viti 1998. Faqja e internetit për zgjedhjet. <[http://www.izbori.gov.mk/par2002/kon\\_rezultati/REZULTATI.htm](http://www.izbori.gov.mk/par2002/kon_rezultati/REZULTATI.htm)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>58</sup> Granata mbi Qeverinë e Maqedonisë. SETTimes.

<[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/newsbriefs/setimes/newsbriefs/2007/08/07/nb-02](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/newsbriefs/setimes/newsbriefs/2007/08/07/nb-02)>. E shpallur më 30 nëntor të vitit 2008.

<sup>59</sup> Çarmatimi i popullit do të fillojë sot me kampanjë mediale. Dnevnik.

<<http://star.dnevnik.com.mk/default.aspx?pbroj=2219&stID=21440&pdate=20030806>>. E shpallur më 23 tetor të vitit 2008.

<sup>60</sup> Proksima. Këshilli i Unionit Evropiane. <[http://www.consilium.europa.eu/cms3\\_fo/showPage.asp?id=584&lang=EN&mode=g](http://www.consilium.europa.eu/cms3_fo/showPage.asp?id=584&lang=EN&mode=g)>. E shpallur më 213 nëntor të vitit 2008.

<sup>61</sup> EUPAT. Këshilli i Unionit Evropian. <[http://www.consilium.europa.eu/cms3\\_fo/showPage.asp?id=994&lang=EN&mode=g](http://www.consilium.europa.eu/cms3_fo/showPage.asp?id=994&lang=EN&mode=g)>. E shpallur më 13 nëntor të vitit 2008.

- Kuvendi maqedonas e miratoi Koncepcionin nacional për siguri dhe mbrojtje, dokument strategjik me rëndësi për sektorin e sigurisë, me të cilin definohen kërcënimet, interesat strategjike dhe vlerat e sigurisë maqedonase.
- U ndalua Akademia ushtarake.


## Viti 2004

- Presidenti Boris Trajkovski vdiq në fatkeqësinë ajrore në Bosnjë, më 27 shkurt. Kryetari i Kuvendit, Lupço Jordanovski, ishte kryetar i përkohshëm deri në zgjedhjet presidenciale, në prill të vitit 2004. Zgjedhjet e reja presidenciale u caktuan për 14 prill të vitit 2004.
- Maqedonia paraqiti edhe kërkesë officiale për anëtarësim në UE, më 22 mars.<sup>62</sup>
- Marrëveshja për stabilizim dhe asocim, e arritur në mes të Unionit evropian dhe Maqedonisë në vitin 2001, hyri në fuqi më 1 prill të vitit 2004.<sup>63</sup>
- U mbajt rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale, pas të cilit, në rrethin e dytë, për funksionin e presidentit garonin Branko Cërvenkovski nga LSDM dhe Sashko Kedev nga OBRM-PDUKM. Rrethi i dytë nga zgjedhjet presidenciale u mbajt dhe Branko Cërvenkovski doli fitues i zgjedhjeve.<sup>64</sup>
- Ligji për organizimin territorial të vetqeverisjes lokale, e parashikuar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit (MKO), u votua nga Kuvendi me 61 vota "për" (në atë kohë Kuvendi numëronte 120 deputetë), më 11 gusht. Ky ligj ishte kyç për orvajtje për anëtarësim të Maqedonisë në UE dhe, edhe më tepër, për zbatimin MKO. U caktua referen-

<sup>62</sup> Komisioni evropian. Zgjerimi i Unionit evropian. <[http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia/eu\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia\\_relations\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/eu_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_relations_en.htm)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>63</sup> Komisioni evropian. Zgjerimi i Unionit evropian. <[http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia/eu\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia\\_relations\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/eu_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_relations_en.htm)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>64</sup> Zgjedhjet, viti 1998. Faqja e internetit për zgjedhjet. <<http://www.izbori.gov.mk/pretsedatski2004/>>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.



dum për decentralizim në vitin 2004 (nëntor), pasi Kongresi gjithmaqedonas botëror mbloodi më shumë se 150.000 nënshkrime për mbajtjen e të njëjtit.<sup>65</sup>

- Referendumi u mbajt më 7 nëntor, me qëllim që të përcaktohet se cilët modele të decentralizimit i parapëlqen populli, gjegjësisht a pëlqehet modeli i bërë në përputhshmëri me Ligjin e vjetër për decentralizim ose me ate të riun. Referendumi ishte i pasukseshëm për shkak të ftesës së dobët (26%, në vend të minimumit prej 50% që nevojitej që të jetë i suksesshëm).<sup>66</sup>
- Hari Kostov ofroi dorëheqje nga funksioni i kryeministrit, duke i theksuar dallimet e patejkalueshme në politikën ekonomike, si edhe arsyet tjetra. Vlado Buçkovski, ish ministri për mbrojtje gjatë kohës së krizës, si edhe gjatë kohës së qeverisë, pjesë e së cilës ishte edhe Hari Kostov, fitoi mandat për të formuar qeveri të re, i cili erdhi në pushtet në dhjetor.<sup>67</sup>
- Policia kufitare morri nga Armata e Maqedonisë patrolimin dhe kontrollin mbi kufitë maqedonas.
- Ministria e punëve të brendshme i krijojti njësitë speciale mobile policore (në mes të popullit të njoitura si *Alfa*), të cilët rregullisht ishin të kritikuara nga ana e sektorit qytetar për shkak të mosrespektimit nga ana e tyre i të drejtave të qytetarëve.

## Viti 2005

- Përgjigjet e Pyetësorit për Maqedoninë nga ana e UE ishin të prezantuar në Brisel nga ana e kryeministrit të atëherëshëm, Buçkovskit.<sup>68</sup>

<sup>65</sup> Të mbledhura mbi 90.000 nënshkrime për referendumin. A1 televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=35136>>. E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.

<sup>66</sup> Referendumi. *Faqja e internetit përzgjedhjet*. <<http://www.izbori.gov.mk/referendum2004/>>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>67</sup> Veteranët e ushtrisë dhe të policisë akuzojnë për korrupcion. A1 televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=44156>>. E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.

<sup>68</sup> Komisioni evropian. Zgjerimi i Unionit evropian. <[http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia/eu\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia\\_relations\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/eu_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_relations_en.htm)>. O E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.


- Në mars u mbajtën zgjedhjet lokale. Për rrethin e parë të zgjedhjeve lokale, misioni vrojtues i OBSE paraqiti parregullësi. Rrethi i dytë i zgjedhjeve u bojkotua nga ana e PDSH dhe PPD.
- Maqedonia, e cila u betua për bashkëpunim me Tribunalin ndërkombëtar penal për ish Jugosllavinë, e ekstradoi në Hagë ish ministrin e punëve të brendshme, Lube Boshkovski, në mars, pas ikjes së tij nga Maqedonia, kur u kap dhe u arrestua dhe u ndalua nga ana e policisë kroate. Johan Tarçulovski, përfaqësues i njësisë speciale të forcave maqedonase të sigurisë, iu bashkangjitet Boshkovskit në Hagë.<sup>69</sup>
- U miratua Ligji për përdorimin e flamujve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë, me çka teknikisht i zbatua MKO. Ky ligj fuqishëm kontestohej gjatë kohës së debateve të gjata të cilat filluan në qershor të vitit 2005.
- Premierit Buçkovski për pak do t'i votohej mosbesimi në shtator.
- Më 9 nëntor, Komisioni evropian sugjeroi që Maqedonisë duhet t'i ndahet statusi i kandidatit për hyrje në UE.<sup>70</sup>
- Samiti i dhjetorit në Brisel e miratoi statusin e kandidatit, por nuk përcaktoi dadën për fillimin e bisedimeve.<sup>71</sup>
- UE e themeloi Timin këshillënës policor të UE (EUPAT), me qëllim që i nejti të zëvendësohet me misionin *Proksima*.<sup>72</sup>
- Ministria për mbrojtje e themeloi Njësinë përgatitje për kthim në jetën civile e cila kishte për qëllim që t'i përgatisë përfaqësuesit e Armatës për kthim në jetën civile, pas përfundimit të karrierës së tyre në Armatë. Përfaqësuesit e Armatës sérish kaluan nëpër trajnim

<sup>69</sup> Hagu ngriti akuzë kundër Boshkovskit dhe tarçulovskit. A1 televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=44109>>. E shpallur më 26 tetor të vitit 2008.

<sup>70</sup> Komisioni evropian. Zgjerimi i Unionit evropian. <[http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia/eu\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia\\_relations\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/eu_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_relations_en.htm)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>71</sup> Komisioni evropian. Zgjerimi i Unionit evropian. <[http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia/eu\\_the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia\\_relations\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/eu_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_relations_en.htm)>. O E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.

<sup>72</sup> EUPAT. Këshilli i Unionit Evropian. <[http://www.consilium.europa.eu/cms3\\_fo/showPage.asp?id=994&lang=EN&mode=g](http://www.consilium.europa.eu/cms3_fo/showPage.asp?id=994&lang=EN&mode=g)>. E shpallur më 13 nëntor të vitit 2008.



për t'u pajisur me shkathtësi të cilat konsiderohen të dobishme për tranzicion në jetën civile.

## Viti 2006

- Në maj, Kuvendi e lejoi ndalesën për regrutim të obligueshëm në Armatë dhe profesionalizimin e Armatës, përmes vizitës të Akademisë ushtarake, çka parashihte një ndër kushtet për anëtarësim në NATO.
- Pas një serie të shpërthimeve dhe të dhunës armiqësore në mes të dy partive udhëheqëse shqiptare (PDSH dhe BDI), pasoi deklarimi për vazhdimin e procesit zgjedhor pa dhunë (në qershor të vitit 2006), nën patronatin e përfaqësuesit të UE në Maqedoni – Ervan Fuere dhe ambasadores amerikane në vendin tonë – Xhulijan Milovanoviç.<sup>73</sup>
- Më 15 korrik u mbajtën zgjedhjet parlamentare, gjatë së cilës erdhë deri te ndryshimi i strukturës udhëheqëse. OBRM-PDUKM fitoi 44 mandate deputetësh (nga gjithsej 120) dhe me to fitoi në zgjedhje. Rrethi i dytë u mbajt në disa vendëvotime, kurse në një vend votimi u prish për shkak të përdorimit të tepërt të dhunës dhe vandalizmit mbi kutitë e votimit. OBRM-PDUKM fitoi më shumë mandate deputetësh edhe në rrethin e dytë, andaj Nikolla Gruevski, kryetar i partisë, fitoi mandatin për të formuar qeverinë. Partia shqiptare e cila fitoi më së shumti vota ishte BDI. Kuvendi i ri e miratoi qeverinë në krye me Nikolla Gruevskin, në gusht, ku OBRM-PDUKM ishte parti udhëheqëse, me parti më të vogla si partnere të koalicionit. BDI vazhdoi të kundërshtojë për shkakun se nuk ishte e përfshirë në Qeveri, ngase ajo e fitoi shumicën e votave të shqiptarëve.<sup>74</sup>
- Në tetor u shkarkua Prokurori publik, Përçevski, mbi bazë të joprofesionalizmit dhe joefikositët.<sup>75</sup>

<sup>73</sup> Fund për dhunën parazgjedhore. A1 televizija. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=64488>>. E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.

<sup>74</sup> Zgjedhjet të njohura edhe për betejën personale të një pjese të aktorëve. A1 televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=35136>>. E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.

<sup>75</sup> Parlamenti e shkarkoi Përçevskin. A1 Televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=72583>>. E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.


- Reformat në polici vazhduan në nëntor, me miratimin e Ligjit për polici. Ligi për polici ndikoi në decentralizimin me rëndësi të policiës dhe barti kompetenca në lidhje me emërimin e kreverte të policisë në njësitë lokale qeveritare. Kjo u krye pa përkrahjen e BDI dhe PPD, të cilët tërroqën vërejtjen se prefektët e tyre nuk do të bashkëpunojnë me policinë.<sup>76</sup>
- Vlado Buçkovski u shkarkua si lider i LSDM, pas votimit të mosbesimit dhe në dhjetor ishte i zëvendësuar me Radmila Sheqerinska.
- Reformat në gjyqësi gjithshtu vazhduan me zgjedhjet të 8 anëtarëve të Këshillit gjyqësor. Kjo shkonte në llogari të rritjes së objektivitetit të Këshillit, anëtarët e të cilët në atë moment nuk i zgjedhët më Kuvendi, por vetë gjyqtarët.

## Viti 2007

- Qeveria maqedonase e ndërroi emrin e aeroportit të Shkupit në "Aleksandri i Madh", çka Greqia e konsideronte se paraqet shkelje të marrëveshjes së përkohshme.<sup>77</sup>
- Në mars, Gruevski u takua me liderin e opozitës shqiptare dhe ish liderin e UÇK, Ali Ahmeti, dhe u morrën vesh ta çfrenojnë (deri në atë moment) dialogun e frenuar politik, si dhe të mbajnë takim në të cilin me shumicën e Badenterit do të miratohen ligjet të cilat i tangojnë pakicat.
- Më 20 maj, pjesë e koalicionit udhëheqës u bë parti tjetër e koalicionit – PPD. Pas kësaj, BDI përfundimisht vendosi të mos e bojkotojë më parlamentin dhe hyri në parlament.
- Në qershor, opozita shtroi propozim për votim të mosbesueshmërisë e cila u refuzua nga ana e Kuvendit. Kjo u ndiq me braktisje të shkurtë të Kuvendit nga ana e LSDM, për shkak të kushteve paraqishtë marrura vesh me BDI. Si edhe të jetë, ata u kthyen në aspx?VestID=68866>. E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.

<sup>76</sup> Parlamenti e solli Ligjin për polici. A1 televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=69550>>. E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.

<sup>77</sup> Bakojani e ftoi Nimicin që të ripërtrohi bisedimet për emrin. A1televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=72583>>. E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.



kabinet dhe së bashku me partitë tjera u morrën vesh se do të vazhdojnë me reformat në kabinet.

- Në gusht u takua Këshilli shtetëror për siguri, me qëllim që të diskutohen kërcënimet potenciale të sigurisë nga Kosova. Pak më vonë pasoi edhe një sulm mbi objektin e Qeverisë.
- Debati parlamentar në mes të PDSH dhe BDI rezultoi me shkëmbim të grushtave në mes të anëtarëve të të dy partive, në korridor, para hyrjes kryesore në Kuvend, dhe i nevojës për intervenim policor.
- Dy gjuqtarët e Gjyqit kushtetues (nga të cilët njëri ishte kryetari i gjyqit) dhanë dorëheqje për shkak të vendimit të gjyqit t'i kufizojë përdorimin dhe theksimin e flamurit shqiptar para objekteve të interesit publik.<sup>78</sup>
- Më 7 nëntor, policia ishte e kyçur në operacionin Stuhia malore, në afërsi të fshatit Brodec, kundër grupit kriminel me prejardhje etnike shqiptare, ku u vritën 8 teroristë dhe u konfiskua një sasi e madhe e armatimit.<sup>79</sup> Edhe përskaj uratave për operacion efikas të njësive multiethnike policore, veprimi i polisës në këtë operacion u bë lëndë për kritikë nga ana e subjekteve politike shqiptare dhe pikë kontestuese për marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni.

## Viti 2008

- Opozita parlamentare (LSDM dhe BDI) kërkuau dorëheqje nga ana e Gordana Jankulovka, ministreshë për punë të brendshme, për shkak të operacionit në Brodec.
- PDSH u bë pjesë e koalicionit udhëheqës qeveritar pas disa ditëve krize për shkak të braktisjes të Kuvendit, si rezultat i mos-marrëveshjes në raport me të drejtat e pakicave.<sup>80</sup>

<sup>78</sup> Tredafil Ivanovski, kryetar i ri i Gjyqit kushtetues. A1 televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=85646>>. E shpallur më 27 tetor të vitit 2008.

<sup>79</sup> Gjashtë të vdekur dhe 13 të arrestuar në aksionin Stuhia malore. A1 televizioni. <<http://www.a1.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=85852>>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>80</sup> PDSH kthehet në Qeverinë maqedonase. SetTimes. <[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/newsbriefs/2008/03/24/nb-01](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/newsbriefs/2008/03/24/nb-01)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.


- Greqia aplikoi veton për ftesë për anëtarësim të Maqedonisë në NATO, gjatë kohës së Samitit të Bukureshtit, në prill. Maqedonia u la anash nga përparimi në të ashtuquajturën Kartë e Adriatikut, sepse Kroacia dhe Shqipëria fituan ftesë për anëtarësim në NATO.<sup>81</sup>
- Në maj, Maqedonia dhe SHBA nënshkruan Dekleratën për partneritet strategjik dhe bashkëpunim për përfocimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve në fushën e sigurisë, ekonomisë dhe tregtisë.
- Me iniciativë të BDI<sup>82</sup>, Kuvendi shpalli dhe bëri ftesë për zgjedhje të parakohshme, të caktuara për 1 qershor.<sup>83</sup>
- Koalicioni i OBRM-PDUKM fitoi 63 mandate deputetësh (nga gjithsej 120) në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 1 qershor të vitit 2008. Në disa vendëvotime u votua sërisht më 15 qershor. Qeveria e re e premierit Gruevski u zgjodh më 26 korrik dhe në të njejtën u përfshi partia politike shqiptare e cila fitoi më së shumti vota gjatë zgjedhjeve – BDI. Zgjedhjet ishin përplot me parregullësi me rastin e rrethit të parë, pas së cilës pasonte një përmirësim i vogël në rrethin e dytë. Zbatimi i sygjerimve nga misioni i OBSE/ODIHR<sup>84</sup>, e cila ishte përgjegjëse për monitorimin e zgjedhjeve, u vendos si përcaktimi i nëntë për fitimin e datës për bisedime për kyçje.
- PDSH paralajmëroi bojkotimin e Kuvendit, më 11 korrik; socijaldemokratët në opozitë iu bashkangjitën më 17 korrik, pas burgosjes së nënkytarit të LSDM, Zoran Zaev, i cili ishte akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare si prefekt i Strumicës. Kryetari Cërvenkovski fitoi përfund të bojkotit, më 31 korrik, dhe deklaroi se do abolojë Zaevin.

<sup>81</sup> Deklerata në Samitin e Bukureshtit, e dhënë nga shefat e shteteve dhe qeverive të cilët morrën pjesë në mbledhjen e Këshillit verioatlantik në Bukuresht, më 3 prill të vitit 2008. *Samiti i NATO-s në Bukuresht, viti 2008*. <[http://www.summitbucharest.ro/en/doc\\_201.html](http://www.summitbucharest.ro/en/doc_201.html)>. E shpalitur më 28 tetor të vitit 2008.

<sup>82</sup> BDI bëri ftesë për zgjedhje të parakohshme parlamentare. SetTimes. <[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/newsbriefs/2008/04/08/nb-02](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/newsbriefs/2008/04/08/nb-02)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>83</sup> Parlamenti maqedonas shpalli zgjedhje të parakohshme të caktuara për qershor. SetTimes. <[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/newsbriefs/2008/04/13/nb-01](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/newsbriefs/2008/04/13/nb-01)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>84</sup> Misioni vëzhgues për bartjen e konfliktit e OBSE në Shkup. OBSE. <<http://www.osce.org/skopje/>>. E shpallur më 3 dhjetor të vitit 2008.



- Më 10 korrik, Lube Boshkovski u lirua nga ana Trubunalit penal ndërkontebtar për ish Jugosllavinë (TPNJ). Tarçulovski u denua me dënim me burg deri në 12 vjet dhe për rastin e tij u lëshua ankesë.<sup>85</sup>
- Pas dorëheqjes së Shekerinskës, LSDM e zgjodhi Zoran Zaevin për kryetar të përkohshëm në vitin 2008, deri në kalimin e mandatit të presidentit të sotëm, Branko Cërvenkovski.<sup>86</sup>
- Më 17 nëntor Maqedonia paraqiti ankesë kundër Greqisë në GJND, në bazë të shkeljes së marrëveshjes së përkohshme nga viti 1995 nga ana e Greqisë, me bllokimin e ftesës për anëtarësim të Maqedonisë në NATO, me çka Maqedonia e humbi ftesën për anëtarësim në NATO.<sup>87</sup> Mosmarrëvesha maqedonaso-greke për emrin, pika kyçë për anëtarësim në NATO, vazhdoi në GJND.

## Viti 2009

- Ministria për mbrojtje e miratoi Programën përmundësi të barabarta të grave dhe burrave, si pjesë e Strategjisë së saj përballafaqim me resurset njerëzore, në përputhshmëri me Ligjin përmundësi të barabarta të grave dhe burrave nga viti 2006. Qëllimi ishte të arrihet integrimi gjinor në ministri dhe të menjanohen pengesat përfomuese të mundësive të barabarta dhe tretman të barabartë të burrave dhe grave.
- Ministria e punëve të brendshme propozoi ndryshime për Ligjin përmundësi të brendshme, me qëllim që të përmirësohet efikasiteti dhe profesionalizmi i policisë.
- Zgjedhjet presedenciale dhe komunale u mbajtën në mars/prill. Gjorgje Ivanov u bë kryetari i ri i shtetit.
- Sërish u formua Akademia ushtarake.


<sup>85</sup> Tribunali i Hagut e liron Boshkovskin, kurse e denoi Tarçulovskin. SetTimes. <[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/features/2008/07/14/feature-02](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2008/07/14/feature-02)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>86</sup> LSDM zgjedh kryetar të ri. SetTimes. <[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/features/2008/09/25/feature-02](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2008/09/25/feature-02)>. E shpallur më 24 tetor të vitit 2008.

<sup>87</sup> Procedime të ngritura nga ana e Ish Republikës Jugosllavë të Maqedonisë kundër Greqisë: Raste të pazgjidhura. *Gjyqi ndërkombëtar përdrejtësi*. <<http://www.icj-cij.org/docket/files/142/14881.pdf>>. E shpallur më 13 nëntor të vitit 2008.

## BIBLIOGRAFI:

- „Galup Balkan monitor: Qasje dhe percepçione – zërat e vendeve ballkanike”, viti 2008. <http://www.balkan-monitor.eu/index.php/dashboard/70-of-macedonian-albanians-supported-ohrid-agreement/>
- Komisioni shtetëror zgjedhor. Rezultatet nga zgjedhjet e vitit 1990-2000. Mund të gjendet në: <http://www.sec.mk/Default.aspx?tabid=855>
- Komisioni evropian. Zgjerim. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Dokumentet kryesore. Mund të gjendet në: [http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the\\_former\\_yugoslav\\_republic\\_of\\_macedonia/key\\_documents\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/candidate-countries/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/key_documents_en.htm)
- Dhoma për sigurimin e personave dhe pronës në RM. Katalogi i agjencive për siguri. Mund të gjendet në: <http://www.obezbeduvanje.org.mk/KomoraContent.aspx?id=232>
- Ministria përmundësi të RM. Historia e ARM. Mund të gjendet në: <http://www.morm.gov.mk:8080/morm/mk/ARM/History/History1.html>
- Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë. Raportet vjetore përpunën e Avokatit të Popullit. Mund të gjendet në: [http://www.ombudsman.mk/default.aspx?clId=104&Lan=MKOhrid\\_Framework\\_Agreement](http://www.ombudsman.mk/default.aspx?clId=104&Lan=MKOhrid_Framework_Agreement): <http://www.siofa.gov.mk/images/dokumente/Ramkoven%20dogovor.pdf>
- Pendarovski, Stevo. „Kontributet ndaj sistemit për siguri nacionale” në Proces, viti 2002: Siguria e Republikës së Maqedonisë. S. Pendarovski, K. Nejkov dhe I. Jusufi (Shkup: Lista, 2002), fq. 11-63.
- Pierson, Paul. Politics in Time: History, Institutions, and Social Analysis. (Princeton: Princeton University Press, viti 2004)
- Pridham, G. “Change and Continuity in EU Political Conditionality: Aims, Approach and Priorities” në Democratization. Vëllimi 14. Nr.3. (qershori, viti 2007), fq. 446-471.



- Rustow, D. "Transitions to Democracy: Towards a Dynamic Model" во Comparative Politics. Vëllimi 2, nr.3, (prill, viti 1970) dhe R. Dahl, Polyarchy: Participation and Opposition. (New Haven: Yale UP, viti 1971).
- Skërbina, Petar., „Rruga e gjatë drejt NATO-s“ në Forum Analitika. Vëllimi 1, (nëntor-dhjetor, viti 2006), fq. 116-138.
- Sotirovska, Natali i Ilievski, Igor „Si punojnë shërbimet maqedonase të sigurisë“. Qendra për komunikime qytetare. Mund të gjendet në: [http://www.ccc.org.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=57%3A2009-05-04-12-29-09&catid=19%3Anatali-naskova-sotirovska&Itemid=21&lang=mk](http://www.ccc.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=57%3A2009-05-04-12-29-09&catid=19%3Anatali-naskova-sotirovska&Itemid=21&lang=mk)
- Enti shtetëror i statistikës. Bruto prodhimi vendor 1990-2000. Viti 2002. ([http://www.stat.gov.mk/pdf/soopstenija\\_28.05.2002/SOOP3.1.2.02.pdf](http://www.stat.gov.mk/pdf/soopstenija_28.05.2002/SOOP3.1.2.02.pdf))
- UNDP. Raporti për tërheqje me kohë të vëmendjes. Viti 2004-2007. UNDP. Mund të gjendet në: [www.ewr.org.mk](http://www.ewr.org.mk)
- UNDP. "I will vote by myself, thank you" në Rod në Evropë dhe ZND. Mund të gjendet në: <http://europeandcis.undp.org/gender/show/30521F9AF203-1EE9-B6D7F1FC3C89B37D>
- Stodiek, Thorsten и Wolfgang Zellner, "The Creation of Multi-Ethnic Police Services in the Western Balkans: A Record of Mixed Success," Deutsche Stiftung Friedensforschung, viti 2007.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Reformat në administratën publike. ([http://rja.gov.mk/files/documents1/Strategija\\_RJA\\_mk.pdf](http://rja.gov.mk/files/documents1/Strategija_RJA_mk.pdf))

*Botuesi:*  
Analytica think tank  
[www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)

Dame Gruev 7-8/3, 1000 Shkup, Maqedoni  
Tel/Fax: +389.2.312.1948  
Email: [info@analyticamk.org](mailto:info@analyticamk.org)

*Autorë:*  
Cvete Koneska – Maqedoni: Raport mbi gjendjen e reformave në sektorin e sigurisë 1991-2008  
Biljana Kotevska – Kronologjia e ngjarjeve lidhur me reformat në sektorin e sigurisë në Republikën e Maqedonisë